Center for Civil Communications
Центар за граѓански комуникации
20 години

NED NATIONAL ENDOWMENT FOR DEMOCRACY
SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

SISTEMI I SHËNDETËSISË SHPENZON GJITHNJË E MË TEPËR NDËRSA JEP GJITHNJË E MË PAK

HULUMTIM

mbi rreziqet nga korrupsioni në prokurimet publike në sektorin e shëndetësisë gjatë periudhës 2015 - 2024

Sistemi i shëndetësisë shpenzon gjithnjë e më tepër, ndërsa jep gjithnjë e më pak

Hulumtim mbi rreziqet nga korrupsioni në prokurimet publike në sektorin e shëndetësisë gjatë periudhës 2015 – 2024

(превод на публикацијата Јавното здравство троши сè повеќе, а дава сè помалку Истражување за корупциските ризици во јавните набавки во здравствениот сектор во периодот од 2015 до 2024 година)

Botuesi: Qendra për Komunikime Qytetare

Autorët: German Filkov, Sabina Fakic and Marko Mitevski

Përktheu nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe: Agon Ismaili

Dizajn grafik: Brigada Dizajn

Edicioni elektronik

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

343.352:[35.073.53:614.2(497.7)"2015/2024"(047.31)

ФИЛКОВ, Герман

Јавното здравство троши сè повеќе, а дава сè помалку [[Електронски извор]] : истражување за корупциските ризици во јавните набавки во здравствениот сектор во периодот од 2015 до 2024 година / Герман Филков, Сабина Факиќ и Марко Митевски ; преведено од македонски на англиски јазик од преведувач Катерина Димишковска ; преведено од македонски на албански јазик од преведувач Агон Исмаили. - Текст во пдф формат, содрж.

44 стр. - Скопје : Центар за граѓански комуникации, 2025

Начин на пристапување (URL): zdravstvo korupcija javni nabavki.pdf

Фусноти кон текстот. - Текст на мак, анг. и алб. јазик. - Наслов преземен од екран. - Опис на изворот на ден 20.11.2025 год. - Содржи и: Public healthcare spends more but provides less: research on corruption risks in healthcare public procurement in the period 2015-2024 / German Filkov, Sabina Fakic and Marko Mitevski ; Sistemi i shëndetësisë shpenzon gjithnjë e më tepër, ndërsa jep gjithnjë e më pak: hulumtim mbi rreziqet nga korrupsioni në prokurimet publike në sektorin e shëndetësisë gjatë periudhës 2015 – 2024 / German Filkov, Sabina Fakic and Marko Mitevski

ISBN 978-608-4974-47-5

1. Факиќ, Сабина [автор] 2. Митевски, Марко [автор]

а) Јавни набавки – Здравствен сектор – Ризици од корупција – Македонија – 2015-2024 – Истражувања

COBISS.MK-ID 67506437

Sistemi i shëndetësisë shpenzon gjithnjë e më tepër, ndërsa jep gjithnjë e më pak

HULUMTIM

mbi rreziqet nga korrupsioni në prokurimet publike në sektorin e shëndetësisë gjatë periudhës 2015 – 2024

Shkup, nëntor 2025

PËRMBAJTJA

1. GJETJET KRYESORE 3

2. KONTEKSTI DHE QASJA METODOLOGJIKE 7

3. HULUMTIM I DETAJUAR 8

3.1 MË TEPËR PARA PËR TENDERËT, MË PAK SHËRBIME PËR PACIENTËT 8

3.1.1. Vlerë e zmadhuar e prokurimeve publike 8

3.1.2. Numër i reduktuar i shërbimeve për pacientët spitalorë 15

3.1.3. Numër i reduktuar i ekzaminimeve specialistike 19

3.1.4. Shpenzimet në rritje në sferën e shëndetësisë kanë qenë kryesisht për mbulimin e nevojave të përditshme 21

3.1.5. Përqendrim i prokurimeve publike në ISHP-të në Shkup 24

3.2 KUR TENDERËT ZMADHOHEN, NDËRSA KONKURRENCA REDUKTOHET 26

3.2.1. Mungesa e konkurrencës e përqendron ndikimin midis një grupi të vogël lojtarësh dominues 26

3.2.2. Mungesa e konkurrencës në prokurimin e reagensëve, testeve dhe materialeve për testime laboratorike 28

3.3 INSULINA, VAKSINAT DHE ILAÇET PËR SËMUNDJE TË RRALLA: MË TEPËR PARA NË PROGRAMET PËR MBROJTJE SHËNDETËSORE, POR JO EDHE KUJDES MË I MIRË PËR PACIENTËT 31

3.3.1. Prokurimi i ilaçeve dhe materialeve të harxhueshme për trajtimin e diabetit 31

3.3.2. Prokurimi i vaksinave për imunizimin e popullsisë 34

3.3.3. Prokurimi i ilaçeve për sëmundje të rralla 36

3.3.4. Llogaridhënie për realizimin e programeve 39

3.4 DOBËSI NË KAPACITETET E RESURSEVE NJERËZORE DHE MEKANIZMAT PËR MBIKËQYRJE 40

3.4.1. Kapacitetet e resurseve njerëzore 40

3.4.2. Mekanizmat për mbikëqyrje 42

1. GJETJET KRYESORE

- Shpenzimet për prokurime publike në sektorin e shëndetësisë janë rritur dy herë e gjysmë në 10 vitet e fundit, nga 126[1] milionë euro në vitin 2015 në mbi 315[2] milionë euro në vitin 2024. Kjo rritje po ndodh në një kontekst ku qytetarët vazhdimisht shprehin pakënaqësi për cilësinë dhe disponueshmërinë e shërbimeve shëndetësore. Diskrepanca evidente midis shpenzimeve si dhe sasisë dhe cilësisë së shërbimeve e forcon përshtypjen se prokurimet publike nuk janë pasqyrim real i nevojave dhe interesave të qytetarëve dhe në mënyrë plotësuese i ushqen mosbesimin dhe dyshimet për korrupsion.
- Inflacioni në periudhën 2021-2024 ndikoi mbi çmimet e pajisjeve, shërbimeve dhe punimeve ndërtimore. Megjithatë, efektet mbi çmimet e ilaçeve ishin të kufizuara për shkakun se çmimet e tyre janë paraprakisht të përcaktuara nga institucionet kompetente. Duke e pasur parasysh se 89% të kontratave për prokurime publike në sferën e shëndetësisë kanë të bëjnë me prokurimin e ilaçeve, materialit mjekësor të harxhueshme dhe mallrave tjera, mund të konstatohet që inflacioni ka pasur ndikim të kufizuar mbi rritjen shumë të madhe.
- Rritja më e madhe e prokurimeve publike është detektuar te klinikat dhe spitalet. Te këto subjekte, në periudhë prej dhjetë vitesh është trefishuar vlera e tenderëve. Mirëpo, në vend që të shtohen shërbimet dhe të përmirësohet kujdesi, qytetarët përballen me një realitet tjetër - tenderët po rriten, ndërkaq puna e spitaleve dhe klinikave po zvogëlohet. Në periudhën 2015 – 2024, numri i ekzaminimeve në gjithsej 55 klinika dhe spitale është reduktuar për 14%, kurse numri i ditëve në spital për 24%. Ky boshllëk hap dyshime serioze se prokurimet publike po përdoren si një kanal për nxjerrje financiare të fondeve, në vend që të përdoren si një instrument për përmirësimin e mbrojtjes shëndetësore.
- Shpenzimet në rritje për prokurimet publike nuk mund të arsyetohen as me ekzaminimet specialistike. Në tre vitet e fundit, në numrin e ekzaminimeve specialistike është regjistruar një rënie prej 700,000, përkatësisht 19%. Reduktimi i numrit të shërbimeve shëndetësore në gjinekologji dhe obstetrikë, si dhe në mjekësinë transfuzive është më tepër se 60%.
- Duke e pasur parasysh se ende nuk është themeluar Sistemi Nacional për Punën Materiale në Institucionet Publike Shëndetësore, si një detyrim ligjor i paraparë që nga viti 2015, dallimet e mëdha në vlerat e tenderëve kundrejt shërbimeve që ofrohen sugjerojnë në rrezik të lartë për keqpërdorime, përkatësisht se ilaçet dhe reagensët nuk janë përdorur për pacientët në institucionet publike shëndetësore.
- Deri 78% të kontratave për prokurime publike lidhen nga institucionet publike të mbrojtjes shëndetësore në Shkup. Ky përqendrim i prokurimeve në kryeqytet është pjesërisht i kuptueshëm për shkak të madhësisë së institucioneve, por në të njëjtën kohë e imponon nevojën për analiza shtesë mbi arsyeshmërinë, si dhe për mbikëqyrje të zmadhuar mbi konsumatorët më të mëdhenj, me qëllim të parandalimit të korrupsionit dhe keqpërdorimeve.

1 Vlera është e korrigjuar për prokurimet publike shumëvjeçare.
2 Vlera është e korrigjuar për prokurimet publike shumëvjeçare.

- Rritja e madhe e vlerave të prokurimeve publike në sektorin shëndetësor shoqërohet me një numër gjithnjë më të vogël të ofertuesve në tenderët. Pothuajse gjysma e vlerës janë në kontratat që lidhen në procedurat e tenderimit në të cilat ka pasur vetëm një ofertues. Në bazë vjetore, këto janë kontrata me vlerë prej 150 milionë euro. Mungesa e konkurrencës ka potencialin për ta përqendruar pasurinë dhe ndikimin midis një grupi të vogël lojtarësh dominues dhe të çojë në rritje të çmimeve, ulje të cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe reduktim të shumëllojshmërisë së ilaçeve.
- Tenderët për prokurimin e reagensëve dhe testeve janë kryesisht vetëm një formalitet sepse ato zhvillohen për ndonjë pajisje tashmë të përzgjedhur, që donë të thotë se edhe para se të fillojë procedura, është e qartë se kush do ta fitojë tenderin. Aparatet janë paraprakisht të fituara si donacione, janë marrë për përdorim nga kompanitë që shesin reagensë ose janë blerë. Prokurimet për reagensë dhe teste në nivel vjetor arrijnë vlerën deri 29 milionë euro dhe gjatë periudhës së analizuar ato kanë shënuar rritje për 8%.
- Tenderët dyvjeçarë për prokurimet për insulinë, glukagon, gjilpëra për insulinë dhe shirita për matjen e sheqerit, pompa të insulinës dhe sensorë matës të glicemisë me vlerë deri në 39 milionë euro zbatohen në procedura në të cilat nuk ka konkurrencë, ndërsa përveç kësaj kontratat e lidhura aneksohen. Gjatë një periudhe prej 10 vitesh, numri i pacientëve në terapi me insulinë është rritur me 2%, kurse vlera e kontratave për 77%. Programet për prokurim të insulinës po zvogëlohen vit pas viti, ndërkaq raportet mbi realizimin e programeve nuk publikohen rregullisht dhe mungon llogaridhënia publike për shpenzimet që bëhen.
- Tenderët për vaksinimin e popullsisë po bëhen gjithnjë e më të shtrenjtë, ndërsa prokurimet e zbatuara në disa vite të caktuara janë të karakterizuara me dobësi - nga faza e planifikimit deri te dështimi për të lidhur kontrata.
- Në dekadën e fundit, shpenzimet për ilaçet për sëmundje të rralla kanë shënuar rritje 90 milionë denarë në 1 miliard denarë (ose nga 1.5 në 19 milionë euro). Kjo rritje e madhe po ndodh në një kohë kur Enti Shtetëror për Revizion sugjeron që Ministria e Shëndetësisë nuk ka të dhëna të plota nëse terapitë vërtet e përmirësojnë shëndetin e pacientëve. Arsyeja për këtë është se për shumicën e sëmundjeve për të cilat prokurohen ilaçe, nuk bëhet evaluimi siç është paraparë me Programin për trajtimin e sëmundjeve të rralla.
- Një nga faktorët e korrupsionit është mungesa e personelit mjaftueshëm të kualifikuar për t'i zbatuar prokurimet. Hulumtimi nxjerr në pah se nga 110 institucione shëndetësore, 23 prej tyre nuk kanë asnjë person, i cili e ka dhënë provimin për prokurime publike, gjë që është në kundërshtim me Ligjin për Prokurimet Publike.
- Pa mekanizma efikas për mbikëqyrje dhe monitorim, ekziston rreziku që të shpenzohen shuma të mëdha parash publike pa u realizuar përmirësime përkatëse.

2. KONTEKSTI DHE QASJA METODOLOGJIKE

Qëllimi i këtij hulumtimi nuk është të vërtetohet korrupsioni në secilën kontratë për prokurime publike, por të demonstrohet që sistemi i themeluar i prokurimeve në sektorin shëndetësor dhe zbatimi i tyre lë hapësirë të konsiderueshme për veprime korruptive dhe keqpërdorim të fondeve publike.

Rëndësia e çështjes së korrupsionit në prokurimet publike në shëndetësi rezulton jo vetëm nga vëllimi i tyre financiar, por edhe nga fakti se parregullsitë në zbatimin e tyre zvogëlojnë efektivitetin dhe drejtësinë e sistemit shëndetësor, përkatësisht ato u pamundësojnë qytetarëve qasje të barabartë dhe çojnë në rënie të cilësisë së shërbimeve shëndetësore.

Hulumtimi i përfshin prokurimet publike në sektorin e shëndetësisë në periudhën nga viti 2015 deri në vitin 2024. Të dhënat për prokurimet publike janë ndërmarrë nga Sistemi Elektronik për Prokurime Publike, ndërsa vëllimi i tyre është i paraqitur në raport me tregues relevantë, siç janë numri i personave me sigurim, numri i ekzaminimeve specialistike, numri i rasteve spitalore, numri i ditëve në spitale, etj. Këto të dhëna janë marrë nga portali e-shëndetësi, i cili të dhënat i merr nga sistemi 'Termini im (Moj termin)', si dhe nga raportet e institucioneve kompetente në fushën e shëndetësisë.

Qëllimi është që të detektohet nëse rritja e vlerës së prokurimeve publike ka kontribuar për rritjen dhe përmirësimin e shërbimeve shëndetësore në sektorin e shëndetësisë apo, përkundrazi, ekziston një disproporcion që mund të sugjerojë në rritje të rreziqeve për korrupsion.

Ky është hulumtimi i parë, në një seri prej tre hulumtimesh të planifikuara mbi prokurimet publike në sektorin e shëndetësisë. Fokusi i kësaj analize është lëvizja e vëllimit dhe shtytësve potencialë të korrupsionit. Hulumtimi i dytë do t'u kushtohet operatorëve më të rëndësishëm ekonomikë, aktorëve kryesorë afaristë në prokurimet publike në sektorin e shëndetësisë dhe dakordimeve potenciale ndërmjet tyre, ndërsa hulumtimi i tretë do të përqendrohet mbi format dhe modelet e korrupsionit që janë zbuluar nëpërmjet ankesave që kompanitë pjesëmarrëse në prokurimet publike i paraqesin në Komisionin Shtetëror për Ankesa për Prokurimet Publike.

Ky hulumtim zbatohet në kuadër të projektit "Parandalimi i Korrupsionit në Prokurimet Publike në sektorin e shëndetësisë", që e zhvillon Qendra për Komunikime Qytetare me mbështetje financiare nga NED.

3. HULUMTIM I DETAJUAR

3.1 MË TEPËR PARA PËR TENDERËT, MË PAK SHËRBIME PËR PACIENTËT

3.1.1. Vlerë e zmadhuar e prokurimeve publike

Shpenzimet për prokurime publike në sektorin shëndetësor janë rritur dy herë e gjysmë në 10 vitet e fundit - nga 126[3] milionë euro në vitin 2015 në mbi 315[4] milionë euro në vitin 2024. Kjo rritje po ndodh në një kontekst ku qytetarët vazhdimisht shprehin pakënaqësi për cilësinë dhe disponueshmërinë e shërbimeve shëndetësore. Diskrepanca e dukshme midis shpenzimeve dhe cilësisë së shërbimeve e forcon përshtypjen se prokurimet publike nuk janë pasqyrim real i nevojave dhe interesave të qytetarëve dhe në mënyrë plotësuese i ushqen mosbesimin dhe dyshimet për korrupsion.

Qëllimi kryesor i prokurimeve publike për ilaçe, materiale dhe pajisje mjekësore është që ato të sigurohen në sasi të mjaftueshme, me cilësi të përshtatshme dhe me një çmim të favorshëm, duke siguruar në këtë mënyrë trajtim me kohë dhe me cilësi për pacientët.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të gjitha 110 institucionet shëndetësore zbatojnë prokurime për nevojat e tyre. Gjithashtu, Ministria e Shëndetësisë dhe Institucioni Publik nga fusha e shëndetësisë për nevojat e institucioneve publike shëndetësore - klinikat universitare, Instituti dhe Qendra e Emergjencës – Shkup, zbatojnë prokurime të centralizuara për disa institucione. Ky model duhet të mundësojë që të dakordohen çmime më të ulëta për disa prokurime të caktuara, por në të njëjtën kohë e largon Ministrinë nga funksioni i saj kryesor - krijimi dhe përmirësimi i politikave shëndetësore. Hulumtimet në kontekstin ndërkombëtar tregojnë se ndjeshmëria ndaj korrupsionit nuk varet prej faktit nëse prokurimet janë të centralizuara apo të decentralizuara, por nga mënyra se si zbatohet dhe si është i themeluar procesi i prokurimeve dhe cila është shkalla e integritetit të personave përgjegjës.

Prokurimet publike në sektorin e shëndetësisë, me një pjesëmarrje prej 22% të totalit të prokurimeve, është kategoria e dytë më e madhe e prokurimeve në shtet (menjëherë pas institucioneve për shërbime të përgjithshme publike), që e bën atë edhe një nga sektorët më të ndjeshëm ndaj korrupsionit.

3 Vlera rregullohet për prokurimet publike shumëvjeçare.
4 Vlera rregullohet për prokurimet publike shumëvjeçare.

Ministria e Shëndetësisë është ndër institucionet me vlerën më të lartë të prokurimeve në vend, ku disa nga tenderët i zbaton për periudhë prej dy ose tre vitesh (për shembull, tenderët për insulinën dhe vaksinat). Prandaj, në këtë hulumtim, tenderët shumëvjeçarë janë ndarë sipas viteve me qëllim që të paraqitet një pasqyrë objektive e vlerave vjetore të prokurimeve në sektorin e shëndetësisë.

Në periudhën 2015 - 2024, vlera e prokurimeve publike ka shënuar rritje për 151%. Më saktësisht, në vitin 2015, vlera e prokurimeve publike ka qenë rreth 8 miliardë denarë, përkatësisht 126 milionë euro, ndërsa në vitin 2024 vlera e tyre ka qenë 19 miliardë denarë, përkatësisht 315 milionë euro.

Përveç në periudhën e krizës me KOVID, rritje të mëdha në vlerën e tyre janë vërejtur edhe në vitin 2016 dhe në vitin 2023.

Rritja e vlerës së prokurimeve ndodh në të njëjtën periudhë kur numri i personave me sigurim në shtet është reduktuar për më tepër se 19 mijë persona (1.05%), edhe atë nga 1,859,027 persona në vitin 2015 në 1,839,537 persona në vitin 2024.

Vlera e tenderëve në fushën e sektorit të shëndetësisë

Viti	Vlera e kontratave të lidhura (denarë)	Vlera e kontratave të lidhura (euro)	Vlera e kontratave të lidhura e korrigjuar për tenderët shumëvjeçarë (denarë)	Vlera e kontratave të lidhura e korrigjuar për tenderët shumëvjeçarë (euro)	Përqindja e ndryshimit
2015	8,297,320,752	134,915,785	7,738,774,169	125,833,726	/
2016	8,706,689,848	141,572,193	9,272,947,601	150,779,636	19.82%
2017	7,951,489,927	129,292,519	9,006,084,443	146,440,397	-2.88%
2018	10,438,161,082	169,726,196	9,719,734,562	158,044,464	7.92%
2019	10,652,420,224	173,210,085	10,157,215,621	165,157,978	4.50%
2020	10,153,744,022	165,101,529	11,353,090,059	184,603,090	11.77%
2021	16,764,439,295	272,592,509	13,459,557,650	218,854,596	18.55%
2022	11,627,558,565	189,065,993	14,693,451,554	238,917,911	9.17%
2023	19,087,345,180	310,363,336	17,442,866,659	283,623,848	18.71%
2024	18,048,613,864	293,473,396	19,400,023,749	315,447,541	11.22%

Përllogaritjet për vlerën e prokurimeve publike janë bërë duke u bazuar në vlerën e kontratave të lidhura dhe kjo është e pashmangshme, për dy arsye kryesore. Së pari, në periudhën e 6 viteve të fundit, përkatësisht që nga miratimi i Ligjit të ri për Prokurimet Publike në vitin 2019 njoftimet për kontratat e lidhura parashtrohen në SEPP. Së dyti, të dhënat për kontratat e lidhura nuk përmbajnë të dhëna të përpikta. Përkatësisht, analiza e të dhënave të Ministrisë së Shëndetësisë, si autoriteti më i madh kontraktues për prokurimet publike në sektorin e shëndetësisë, tregon se 88% e kontratave janë lidhur në periudhën 2019-2025. Megjithatë, nëse i futemi një analize më të thelluar, arrijmë në përfundimin se disa kontrata janë realizuar në shuma më të larta nga ato që janë paraqitur në Sistemin Elektronik të Prokurimeve Publike. Një shembull për këtë është prokurimi i ilaçeve për sëmundje të rralla për

vitin 2022, ku vlera e kontratave të lidhura të paraqitura në SEPP arrin shumën 444,022,063 denarë. Përkundër kësaj, në raportin për realizimin programor dhe buxhetor të Programit për Sëmundjet e Rralla në Republikën e Maqedonisë për vitin 2022, thuhet se realizimi financiar i programit është në lartësinë e fondeve të miratuara me shumën prej 657.000.000 denarë.

Pohimi që kontratat e lidhura kanë një përqindje të lartë realizimi konfirmohet edhe nga fakti se në periudhën 2019 - 2025, ISHP Klinika Universitare për Radioterapi dhe Onkologji (e dyta më e madhe me prokurime publike), në Sistemin Elektronik për Prokurime Publike ka regjistruar të dhëna për realizimin e 92% të kontratave të lidhura.

Gjithashtu është me rëndësi të theksohet se disa nga prokurimet, veçanërisht ato për pajisjet mjekësore, janë financuar përmes kredive nga institucionet ndërkombëtare financiare, me ç'rast në të shumtën e rasteve janë aplikuar rregullat e kreditorit, përkatësisht për ato konkretisht nuk ka të dhëna në Sistemin Elektronik për Prokurime Publike (SEPP).

Gjatë këtyre viteve, krahas vlerës, rritje është vërejtur edhe në numrin e kontratave të lidhura. Në vitin 2015 janë lidhur 5,221 kontratë. Rritja e parë e madhe ndodh në vitin 2019, kur numri i kontratave shënon rritje deri në 7,252 kontrata, përkatësisht rritje për 21%, ndërsa rritja e dytë në vitin 2023, kur numri i kontratave arrin deri 8,309.

Numri i kontratave të lidhura

Viti	Numri i kontratave	Përqindja e ndryshimit
2015	5,221	/
2016	5,192	-0.56%
2017	5,738	9.52%
2018	5,693	-0.79%
2019	7,251	21.49%
2020	7,842	7.54%
2021	7,663	-2.34%
2022	7,211	-6.27%
2023	8,309	13.21%
2024	8,534	2.64%

Analiza në nivel institucionesh tregon se Ministria e Shëndetësisë ka vëllimin më të madh të prokurimeve publike, në buxhetin e së cilës, ndër tjerash, vazhdimisht parashihen programe buxhetore për financimin e rindërtimit dhe zgjerimit të objekteve të ISHP-ve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, prokurimin e pajisjeve mjekësore për nevojat e ISHP-ve dhe programe për mbrojtje shëndetësore parandaluese dhe kurative. Në nivel vjetor, vlera e prokurimeve të ministrisë lëviz në shumën nga 49 milionë euro në

vitin 2015 deri në 65 milionë euro në vitin 2024. Prokurimet publike kanë shënuar rritjen më të madhe në vitin 2021, edhe atë me më tepër se 30 milionë euro.

Në vendin e dytë për nga vlera e prokurimeve publike është Klinika për Radioterapi dhe Onkologji, e cila ka një nga rritjet më të mëdha në vlerën e prokurimeve në korrelacion me vitin 2015, edhe atë nga 5.7 milionë euro në përafërsisht 32 milionë euro në vitin 2024. Klinika ka një rritje të konsiderueshme të buxhetit nga Fondi, i cili është zmadhuar nga 863 milionë denarë në vitin 2021 në afërsisht 2 miliardë denarë në vitin 2024. Rritja është përgjithësisht si pasojë e rritjes së kompensimit të kushtëzuar për prokurim të ilaçeve inovative, pra të terapisë biologjike, e cila në vitin 2024 arrin vlerën prej 18 milionë euro.

Klinika për Sëmundje të Fëmijëve gjithashtu ka një rritje të lartë në vlerën e prokurimeve, nga 1 milion euro në vitin 2015 deri përafërsisht 16 milionë euro në vitin 2024. Këtu, rritja është për shkak të prokurimieve të ilaçit modulator 'Ivacaftor/Tezacaftor/Elexacaftor' së bashku me 'Ivacaftor' - buxhet i kushtëzuar; pastaj të terapisë biologjike (Adalimumab, Eltrombopag, Dinutuximab beta, Etanercept, Anakinra, Infliximab) Hormonit Somatotropik (Somatropin) dhe Terapisë me Inhalim për Fibrozën Cistike (Tobramicinë, Dornase alfa, Colistin (colistimetat)), si dhe ilaçeve për terapi biologjike, hormonit të rritjes, terapisë me inhalim dhe terapisë për trombocitopeninë imune kronike, të gjitha nga buxheti i kushtëzuar.

Institucionet shëndetësore me vlerën më të lartë të prokurimeve publike 2015 - 2024 (në euro)

Institucioni	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Ministria e Shëndetësisë[5]	49,321,482	49,689,551	27,931,923	28,298,890	51,734,179	45,105,820	75,805,580	69,808,537	61,808,877	64,757,281
Klinika Universitare për Radioterapi dhe Onkologji	5,683,860	7,295,034	10,103,269	8,250,078	4,549,855	5,366,200	6,047,648	11,244,909	29,261,708	31,836,721
Klinika Universitare për Sëmundjet e Fëmijëve	1,062,111	1,739,979	1,209,561	2,982,039	3,205,594	3,141,678	2,334,750	4,318,341	5,363,756	15,959,667
ISHP Spitali i Përgjithshëm i Qytetit "8 Shtatori" Shkup	8,886,916	10,465,435	11,220,130	11,782,839	12,044,610	11,850,238	12,125,196	10,672,777	13,316,970	13,243,148
Institucioni publik në fushën e kujdesit shëndetësor...	7,576,215	5,025,133	8,225,609	8,093,181	7,995,860	7,712,168	12,260,079	11,172,859	9,178,271	12,003,013
Klinika Universitare e Hematologjisë	3,004,668	3,324,409	4,296,864	5,095,653	656,925	6,020,848	1,738,709	4,837,750	9,454,957	11,016,620
Klinika Universitare e Kardiologjisë - Shkup	2,513,327	4,458,979	5,241,732	5,044,875	5,111,204	6,247,144	3,172,878	7,464,041	6,666,037	9,636,003
Klinika Universitare e Neurologjisë	840,156	282,047	1,879,083	2,066,654	2,973,786	1,623,654	3,323,974	527,485	2,098,874	7,155,665
Instituti i Mjekësisë Transfuzive i RVM-së	3,203,531	4,242,258	7,883,934	6,171,746	4,550,608	5,699,696	5,333,039	5,885,448	6,982,660	6,721,579
Shtëpia e Shëndetit - Shkup	3,020,277	1,972,365	5,039,078	1,212,965	1,214,346	2,299,052	2,136,373	4,104,108	6,225,056	6,303,394

5 Vlerat vjetore të prokurimeve publike të Ministrisë së Shëndetësisë janë korrigjuar përkitazi numrit të viteve me të cilat ndërlidhen prokurimet.

Dy faktorët e mëposhtëm mund të veçohen si faktorë të caktuar të jashtëm që kanë ndikuar në rritjen e vlerës së prokurimeve:

- Inflacioni (2021–2024) – kishte ndikim në çmimet, veçanërisht për pajisjet, shërbimet dhe punët ndërtimore, ndërsa për ilaçet, efektet ishin të kufizuara për shkak të çmimeve maksimale ekzistuese të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë.
- Inkorporimi i një kompensimi të kushtëzuar për ISHP-të – me ndryshimin e Ligjit për Sigurimin Shëndetësor në vitin 2019, Fondi për Sigurim Shëndetësor, me pëlqim paraprak nga Ministria e Shëndetësisë, filloi të miratojë fonde për ISHP-të për prokurimin e ilaçeve të gjeneratës së re/inovative, të ashtuquajturat ilaçe biologjike për trajtimin e disa sëmundjeve që nuk janë në Listën Pozitive të Ilaçeve, e cila para vitit 2024, për herë të fundit është përditësuar në vitin 2015. Sipas të dhënave në dispozicion, shuma e këtij kompensimi është zmadhuar nga 911 mijë euro në vitin 2017 në 28 milionë euro në vitin 2023. Në raportet e revizionit që janë në lidhje me punën e Fondit dhe disa prej ISHP-ve, janë cekur një numër i madh i parregullsive që kanë të bëjnë me mungesën e kontrollit mbi mënyrën se si përdoren këto fonde, si dhe me procedurën jotransparente në ISHP-të gjatë vendimmarrjes për përzgjedhjen e llojit të ilaçeve që do të prokurohen dhe me mungesën e protokolleve për trajtimin e tyre, gjë që krijon rreziqe të larta për aktivitete korrupsioni.

Mirëpo, këta faktorë nuk janë të mjaftueshëm për të shpjeguar disa rritje të mëdha në vlerën e prokurimeve. Gjatë kësaj, duhet të kemi parasysh që përgjithësisht, gjatë periudhës 2022 – 2024 inflacioni është 29.3%. Për shkak të specifikave të sferës së shëndetësisë, çmimet jo vetëm që nuk janë zmadhuar për shkak të kufizimit nga institucionet kompetente, por është vërejtur që te një pjesë e ilaçeve dhe materialeve të harxhueshme ka edhe ulje të çmimeve. Në vijim janë paraqitur disa shembuj të veçuar të prokurimeve, me të cilat janë bërë blerje me sasi më të mëdha ose me çmime më të larta dhe për të cilat është siguruar gjurmueshmëri në një varg më të gjatë të viteve, për t'u identifikuar trendi.

Çmimet e vaksinave për imunizim të popullsisë në RMV

Emri i përgjithshëm	Çmimi individual me TVSH në periudhën 2018/2019 në denarë	Çmimi individual me TVSH në periudhën 2021 në denarë	Çmimi individual me TVSH në periudhën 2023 në denarë	Ndryshimi
Diphtheria-tetanus-pertussis (acellular) - Hemophilus influenzae B - inactive poliomyelitis	1,231	1,231	1,231	0.00%
Diphtheria-pertussis-poliomyelitis-tetanus	961	961	961	0.00%
Diphtheria-poliomyelitis-tetanus	/	854	854	0.00%
Pneumococcus, purified polysaccharides antigen conjugated	2,128	2,128	2,128	0.00%
Rota virus vaccine	1,523	977	977	-35.86%
Diphtheria- tetanus-pertussis (accelular)-hemophilus influenzae B- inactive poliomyelitis- hepatitis B	2,165	2,165	2,069	-4.47%
Hepatitis B, purified antigen	343	343	338	-1.40%
Tuberculosis live attenuated	29	32	32	10.51%
Measles, combination with mumps and rubella, live attenuated	394	394	586	48.82%

Shembuj të veçuar për ilaçet për trajtim të sëmundjeve të rralla.

Çmimet e ilaçeve për trajtimin e sëmundjeve të rralla

Emri i përgjithshëm	Çmimi individual me TVSH në periudhën 2019 në denarë	Çmimi individual me TVSH në periudhën 2024 në denarë	Ndryshimi
A16AB12 elosulfase alfa 5mg/ 5mi influenzae B- inactive poliomyelitis	64,575	61,324	-5.03%
A16AB02 imiglucerase 400 IE	73,395	73,395	0.00%
A16AB09 idursulfase 6mg/ 3ml	207,900	207,900	0.00%

Tabela më poshtë përfshin shembuj që lidhen me prokurimin e terapive hematologjike.

Çmimet e ilaçeve për trajtimi i çrregullimeve hematologjike

Emri i përgjithshëm	Çmimi individual në periudhën 2019 në denarë	Çmimi individual në periudhën 2024 në denarë	Ndryshimi
L01XC17 Nivolumab 100 mg/10ml, vial	89,455	62,700	-29.91%
L04AD01 Ciclosporin, 50 mg pill	27	34	25.92%
L04AD01 Ciclosporin, 100 mg pill	51	54	5.88%

Në vazhdim janë paraqitur edhe çmimet individuale për reagensët dhe testet, si disa nga materialet e harxhueshme që përdoren më së shpeshti në shëndetësi. Siç mund të shihet edhe te materialet e harxhueshme nuk ka rritje të konsiderueshme të çmimeve. Këtu, ndryshimet ndodhin me ndryshimin e aparatit dhe së këtejmi gjurmueshmëria e çmimeve është siguruar te një pjesë e materialeve të harxhueshme.

Çmimet për blerjen e reagensëve dhe testeve

Emri i përgjithshëm	Çmimi individual me TVSH në periudhën 2019/20 në denarë	Çmimi individual me TVSH në periudhën 2021/22 në denarë	Çmimi individual me TVSH në periudhën 2023/24 në denarë	Ndrys-himi
Shishe prej plastmasi të pathyeshëm me reagens nutritiv për detektimin e mikroorganizmave anaerobik dhe anaerobik-fakultativ (bakterie dhe kërpudha) të aplikueshme për aparatin Bact/Alert 3D60 ose ekuivalent	1,218	1,304	1,304	7.06%
Shishe prej plastmasi të pathyeshëm me reagens nutritiv për detektimin e mikroorganizmave aerobik (bakterie dhe kërpudha) të aplikueshme për aparatin Bact/Alert 3D60 ose ekuivalent	1,218	1,304	1,304	7.06%
Teste për multiples skrining molekular të dhuruesve të gjakut, donorë të organeve dhe indesh për këta markerë të viruseve: HCV RNA, HBV DNA, HIV-1 RNA, HIV-2 RNA dhe HEV RNA nga një epruvetë me principin e NAT (nucleic acid testing) teknologjisë, të aplikueshme në aparatin PROCLEIX PANTHER SYSTEM ose ekuivalent të tij		1,254	1,254	0.00%
Shirita për përcaktimin kuantitativ të Kohës së Protrombinës, të aplikueshëm në koagulimetër portativ Xprecia Stride ose ekuivalent të tij	271	271	265	-2.21%
Plazmë kontrolluese për kontroll të Kohës së Protrombinës, e aplikueshme në koagulimetër portativ Xprecia Stride ose ekuivalent të tij	2,832	2,832	3,115	9.65%

Duke i pasur parasysh të dhënat e paraqitura më sipër në lidhje me çmimet, mund të vlerësojmë që ndryshimet në vëllimin e prokurimeve publike për pjesën dërmuese janë si pasojë e ndryshimeve në përbërjen, përkatësisht në lëndën e prokurimeve dhe në sasinë, ndërsa jo në çmimet. Së këtejmi, shtrohet pyetja nëse këto ndryshime gjatë këtyre viteve, që janë çuar në rritje marramendëse të vlerës së prokurimeve, janë bërë për interesin më të mirë të pacientëve dhe kanë lëvizur proporcionalisht me rritjen e shërbimeve për pacientët ose bëhet fjalë për faktorë korrupsioni.

3.1.2. Numër i reduktuar i shërbimeve për pacientët spitalorë

Rritja më e madhe e prokurimeve publike është detektuar te klinikat dhe spitalet. Te këto subjekte, në periudhë prej dhjetë vitesh është trefishuar vlera e tenderëve. Mirëpo, në vend që të shtohen shërbimet dhe të përmirësohet kujdesi, qytetarët përballen me një realitet tjetër – tenderët po rriten, ndërkaq puna e spitaleve dhe klinikave po zvogëlohet. Në periudhën 2015 - 2024, numri i ekzaminimeve në gjithsej 55 klinika dhe spitale është reduktuar për 14%, kurse numri i ditëve në spital për 24%. Ky boshllëk hap dyshime serioze se prokurimet publike po përdoren si një kanal për nxjerrje financiare të fondeve, në vend që të përdoren si një instrument për përmirësimin e mbrojtjes shëndetësore.

Krahasimi i të dhënave për numrin e rasteve spitalore dhe numrin e ditëve në spital me vlerën e prokurimeve publike sugjeron në konstatimin se gjatë një periudhe prej 10 vitesh, numri i rasteve spitalore është zvogëluar për 14.3%, ndërsa numri i ditëve në spital në vitin 2024 është më i ulët se numri i ditëve në vitin 2015 edhe atë për 23.5%. Këto rënie ndodhin në një kohë kur vlera e prokurimeve publike në këto 55 spitale dhe klinika ka shënuar rritje, madje për 216.3%.

Rastet spitalore, si dhe numri i ditëve të kaluara në spitale, janë të dhëna që mund të shihen në raportet vjetore të Fondit për Sigurim Shëndetësor. Shërbimet spitalore ofrohen nga institucionet publike shëndetësore si në vijim:

- 13 spitale komunale edhe atë në Shkup, Strugë, Veles, Gostivar, Kërçovë, Kumanovë, Ohër, Strumicë, Gjevgjeli, Kavadar, Prilep, Dibër dhe Koçani;
- 28 klinika;

- 3 spitale klinike, edhe atë në Shtip, Manastir dhe Tetovë;
- 8 spitale speciale dhe
- 3 spitale psikiatrike.

Numri i shërbimeve në klinika dhe spitale në vitin 2015, sipas raportit vjetor të Fondit për Sigurime Shëndetësore, ka qenë 216,413 me numër total të qëndrimeve spitalore të pacientëve prej 1,197,955 ditësh. Përkundër kësaj, në vitin 2024, numri i shërbimeve për pacientët ka qenë 185,484 shërbime me numër të ditëve në spital prej 916,077 ditësh.

Shërbimet shëndetësore në spitalet kundrejt prokurimeve publike 2015 - 2024

Viti	Numri i rasteve spitalore	Numri i ditëve të qëndrimit në spital	Vlera e prokurimeve publike në euro
2015	216,413	1,197,955	62,586,540
2024	185,484	916,077	197,965,033
Ndryshimi	-14.3%	-23.5%	216.3%

Sa i përket numrit të rasteve spitalore, rënia më e madhe ndodhi në spitalet e përgjithshme dhe spitalet klinike, madje deri 27%. Pas tyre vijon një rënie prej 1.2% në klinikat. Rritje të numrit të rasteve spitalore ka pasur vetëm në spitalet speciale dhe spitalet psikiatrike.

Numri i rasteve spitalore 2015 - 2024

Viti	Klinikat	Spitalet klinike	Spitalet e përgjithshme	Spitalet speciale	Spitalet psikiatrike	Gjithsej
2015	80,023	39,098	81,661	15,568	63	216,413
2024	79,032	28,535	59,462	18,321	134	185,484
Ndryshimi	-1.2%	-27.0%	-27.2%	17.7%	112.7%	-14.3%

Rëniet janë edhe më të theksuara në numrin e ditëve në spital. Në vitin 2024, ky numër është zvogëluar për 364,005 ditë, që paraqet një rënie prej madje 28.4%.

Në vitin 2015, në klinika janë evidentuar 492,186 ditë për dallim nga viti 2014 kur numri i këtyre ditëve ka qenë 407,976 ditë që paraqet një rënie prej 17.1%. Rënia më e madhe prej 39% në numrin e ditëve në spital është regjistruar në Spitalet Klinike. Rritje në numrin e ditëve në spital është regjistruar vetëm në spitalet psikiatrike, edhe atë rritje prej 102.5% dhe në spitalet speciale për 0.5%.

Numri i ditëve në spital 2015 - 2024

Viti	Klinikat	Spitalet klinike	Spitalet e përgjithshme	Spitalet speciale	Spitalet psikiatrike	Gjithsej
2015	492,186	190,040	428,675	85,955	1,099	1,197,955
2024	407,976	115,943	303,562	86,371	2,225	916,077
% e ndryshimit	-17.1%	-39.0%	-29.2%	0.5%	102.5%	-23.5%

Për dallim prej reduktimeve në rastet spitalore dhe numrin e ditëve të qëndrimit në spital, prokurimet publike në dekadën e analizuar kanë shënuar rritje nga 63 milionë në 198 milionë euro (216%). Rritja më e madhe në vlerën e prokurimeve u regjistrua në klinikat, edhe atë për më tepër se 4 herë. Rritja tek pjesa tjetër e institucioneve të analizuara lëviz në vlerat 80.5 - 152.5%. Është me rëndësi të theksohet që rritje të madhe në vlerën e prokurimeve ka në spitalet klinike dhe spitalet e përgjithshme, të cilat ndërkaq, kanë regjistruar reduktime të konsiderueshme në numrin e shërbimeve.

Prokurimet publike në klinikat dhe spitalet 2015 - 2024 (në euro)

Viti	Klinikat	Spitalet klinike	Spitalet e përgjithshme	Spitalet speciale	Spitalet psikiatrike	Totali
2015	28,086,674	6,162,236	19,185,449	7,087,553	2,064,628	62,586,540
2024	123,869,919	15,557,743	39,766,906	15,043,596	3,726,869	197,965,033
% e ndryshimit	341.0%	152.5%	107.3%	112.3%	80.5%	216.3%

Rritja e shpenzimeve, përkundër rënies së produktivitetit dhe cilësisë së shërbimeve, konsiderohet si një tregues i rrezikut për korrupsion. Prokurimet publike janë trefishuar, ndërsa numri i shërbimeve dhe ditëve të shtrimit në spital është reduktuar konsiderueshëm. Ky disproporcion sugjeron në rreziqe serioze për korrupsion dhe shpenzime joefikase të fondeve publike, përkatësisht, prokurimet nuk e ndjekin dinamikën reale të nevojave shëndetësore, por shpesh lëvizin në drejtim të interesave private.

Kjo tregon se prokurimet ndoshta nuk janë të bazuara në nevojat reale të shëndetësisë, por janë të bazuara në interesa private (tenderë të destinuar për kompani të caktuara, faturime joreale ose fiktive, përdorim joefikas dhe pa dedikim i mallrave të blera).

Sipas të dhënave të publikuara në raportet vjetore të FSSH-së, numri i pranimeve në spital në institucionet private shëndetësore për shërbimet për të cilat ato kanë lidhur kontratë me Fondin është vazhdimisht në rritje, edhe atë nga 2,884 pranime gjatë vitit 2015 në 4,660 pranime gjatë vitit 2024. Kjo nënkupton rritje prej 62%. Është e rëndësishme të theksohet se udhëzimet në spitalet private të kujdesit shëndetësor më shpesh kanë të bëjnë me shërbime shëndetësore nga fusha e kardiokirurgjisë dhe oftalmologjisë.

E pamundur ishte të vihet vëllimi i zmadhuar i prokurimeve publike në raport me numrin e intervenimeve kirurgjikale për shkak që disa spitale e fshehin informacionin për numrin e intervenimeve të kryera kirurgjikale, me çka opinioni nuk ka mundësi për këqyrje reale në efikasitetin e punës së tyre.

Institucionet publike shëndetësore duhet rregullisht të raportojnë për intervenimet e kryera kirurgjikale dhe të mundësojnë që të dhënat të jenë në dispozicion për të gjithë qytetarët nëpërmjet ueb-portalit "e-shëndetësi". Raportet duhet t'i përmbajnë të dhënat si në vijim:

- numrin e përgjithshëm të intervenimeve në nivel të institucionit;
- numrin e përgjithshëm të intervenimeve sipas llojit të intervenimit dhe
- numrin dhe llojin e intervenimeve për çdo mjek, me emrin dhe mbiemrin e shënuar dhe institucionin në të cilin punon.

Mirëpo, ky obligim shpeshherë nuk respektohet, madje as nga institucionet më të mëdha shëndetësore. Pra, për shembull, SPQ "8 Shtatori", për vitin 2024 ka raportuar të dhëna për vetëm 2 intervenime të kryera, që është numër i ulët dhe joreal. Përkundër kësaj, institucionet private shëndetësore, që kanë lidhur marrëveshje me FSSH, sikur rregullisht i dërgojnë të dhënat për intervenimet e kryera në kurriz të buxhetit të shtetit.

Me këtë mospërmbushje të obligimit për informim publik për intervenimet e kryera kirurgjikale nga institucionet publike shëndetësore, kufizohet transparenca dhe llogaridhënia. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për spitalet e mëdha kur ekziston e ashtuquajtura veprimtari shtesë, përkatësisht mundësia që mjekët të kryejnë ekzaminime dhe operacione në suazat e institucioneve publike shëndetësore, por edhe për t'i inkasuar ato nga pacientët, në bazë private dhe në shumën e plotë të kostos. Vet mospublikimi i këtyre të dhënave krijon shqetësim të arsyeshëm për trendë të mundshme negative.

Kështu, përderisa institucionet publike shëndetësore i fshehin të dhënat, rezulton që numri i intervenimeve kirurgjikale në institucionet private shëndetësore rritet. Në vitin 2022, numri i intervenimeve në institucionet private shëndetësore ka qenë 3,123, ndërsa në vitin 2024 ky numër ka qenë 3,760, që paraqet rritje për 20%.

3.1.3. Numër i reduktuar i ekzaminimeve specialistike

Shpenzimet në rritje për prokurime publike nuk mund të arsyetohen as me ekzaminimet specialistike. Në tre vitet e fundit, në numrin e ekzaminimeve specialistike është regjistruar një rënie prej përafërsisht 700 mijë, përkatësisht për 19%. Reduktimet në numrin e shërbimeve shëndetësore në gjinekologji dhe obstetrikë, si dhe në mjekësinë transfuzive, janë më tepër se 60%.

Sipas të dhënave të publikuara në portalin e-shëndetësi.mk, numri i ekzaminimeve specialistike të realizuara në vitin 2022 iu afrua numrit prej 3.6 milionë ekzaminime, në vitin 2023 është zvogëluar në rreth 3 milionë ekzaminime, ndërsa në vitin 2024 ka pësuar rënie shtesë, edhe atë deri në 2.9 milionë ekzaminime specialistike. Kjo flet për një rënie prej madje 19% në periudhën 2022-2024.

Reduktim i numrit të ekzaminimeve specialistike



Vështruar në nivel specializimi, zvogëlimet shkojnë edhe më tepër se 60%. Kështu, sipas të dhënave të publikuara në e-shëndetësi.mk, nga pesëmbëdhjetë fushat në të cilat qytetarët kanë nevojë për numrin më të madh të ekzaminimeve të specializuara, në njëmbëdhjetë prej tyre ka rënie në numrin e ekzaminimeve.

Siç mund të shihet nga paraqitja tabelore, në fushën e mjekësisë interne, numri i ekzaminimeve të kryera në vitin 2022 është 626,815, ndërsa në vitin 2024 ky numër ka pësuar rënie për një të tretën dhe është zvogëluar në 409,119 ekzaminime.

Paraqitje e trendeve të ekzaminimeve specialistike, të cilat më së shumti shfrytëzohen nga qytetarët

Specializimi	Udhëzime të realizuara 2022	Udhëzime të realizuara 2024	Dallimi	Dallimi në%
Mjekësi interne	626,815	409,119	-217,696	-34.7%
Oftalmologji	236,238	208,345	-27,893	-11.8%
Otorinolaringologji	216,689	225,347	8,658	4.0%
Ortopedi	214,343	188,986	-25,357	-11.8%
Pediatri	187,300	169,746	-17,554	-9.4%
Mjekësia e transfuzionit	183,378	68,330	-115,048	-62.7%
Psikiatri	166,682	153,255	-13,427	-8.1%
Kardiologji	154,546	108,881	-45,665	-29.6%
Neurologji	152,457	155,251	2,794	1.8%
Dermatovenerologji	147,088	165,772	18,684	12.7%
Obstetrikë dhe gjinekologji	123,480	48,750	-74,730	-60.5%
Urologji	123,230	109,315	-13,915	-11.2%
Mjekësia Fizike dhe Rehabilituese	116,709	122,274	5,565	4.8%
Kirurgji e përgjithshme	109,758	91,657	-18,101	-16.5%
Sëmundjet Infektive	101,357	97,913	-3,444	-3.4%

Rënia më e madhe e numrit të udhëzimeve të realizuara është në fushën e mjekësisë transfuzive, me 63% dhe në fushën e obstetrikës dhe gjinekologjisë deri 61%.

Nga ana tjetër, rritje e numrit të ekzaminimeve është detektuar në fushat e dermatovenerologjisë, edhe atë për 13%, mjekësisë fizikale dhe rehabilituese për 5%, otorinolaringologjisë për 4% dhe neurologjisë për rreth 2%.

Në drejtim të krijimit të një pasqyre reale të gjendjeve, duhet të merren parasysh edhe mospërputhjet në mënyrën e caktimit të terminëve për ekzaminime specialistike, si dhe në evidencën për ato. Konkretisht, gjithnjë e më pak po respektohet detyrimi ligjor për t'i publikuar terminët e rregullt përmes një kalendari mujor të aktiviteteve dhe një numër i madh i ISHP-ve publikojnë një numër më të vogël nga numri i përcaktuar. Një numër i madh i ekzaminimeve specialistike kryhen me udhëzime me urgjencë dhe me prioritet, ndërkaq disa ISHP kryejnë kontrolle me udhëzime me urgjencë dhe pa termin në numër afërsisht të njëjtë me terminët e rregullt, gjë që ndikon në qasjen e barabartë në shërbimet shëndetësore për shfrytëzuesit.

Kjo konfirmohet edhe nga të dhënat e fituara nga Administrata për Shëndetësi Elektronike, sipas të cilave në vitin 2016 janë publikuar 2,623,841 terminë për kontrolle, ndërsa në vitin 2024 janë publikuar 1,776,429 terminë. Rënia që ka ndodhur për 9 vite në numrin e terminëve është deri me një të tretën.

3.1.4. Shpenzimet në rritje në sferën e shëndetësisë kanë qenë kryesisht për mbulimin e nevojave të përditshme

Nga totali prej 1.9 miliardë euro të shpenzuara në 10 vitet e fundit, vetëm 56 milionë euro (3%) janë shpenzuar për ndërtimin dhe rindërtimin e objekteve të kujdesit shëndetësor. 59 milionë euro janë shpenzuar për pajisje dhe aparate mjekësore (këtu nuk përfshihen pajisjet e blera me kredi nga Banka Botërore dhe nga kreditorë të tjerë). Pjesa më e madhe e shpenzimeve për prokurime publike në sektorin shëndetësor është për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve për punën rrjedhëse, me vlerë totale prej 1.7 miliardë euro dhe pjesëmarrje prej 89%.

Në periudhën dhjetëvjeçare 2015 - 2024, madje 89% e prokurimeve janë në lidhje me mallra, 8% me shërbime dhe 3% me punime ndërtimi.

Struktura e prokurimeve publike në sektorin e shëndetësisë 2015-2024



Siç mund të shihet nga tabela në vijim, në periudhën 2015 - 2024, më tepër se 1.7 miliardë euro janë shpenzuar për prokurim të mallrave (ilaçe, material i harxhueshëm, ushqim, furnizime për mirëmbajtje, energji elektrike, derivate të naftës, etj.), pastaj, rreth 153 milionë euro për shërbime (pastrim, mirëmbajtje e pajisjeve, etj.), ndërsa vetëm 56 milionë euro për punime ndërtimi, edhe atë ndërtimi i objekteve të reja ose rindërtimi i objekteve shëndetësore ekzistuese.

Struktura e prokurimeve publike në kujdesin shëndetësor në periudhën 2015 - 2024

Viti	Prokurimi i mallrave		Prokurimi i shërbimeve		Prokurimi i punimeve	
	Vlera (euro)	Pjesëmarrja	Vlera (euro)	Pjesëmarrja	Vlera (euro)	Pjesëmarrja
2015	116,518,271	86.4%	9,575,908	7.1%	8,820,955	6.5%
2016[6]	104,250,198	82.9%	10,601,651	8.4%	10,942,403	8.7%
2017[7]	101,409,000	90.0%	10,554,665	9.4%	776,884	0.7%
2018[8]	132,100,411	90.6%	10,449,052	7.2%	3,283,676	2.3%
2019[9]	157,166,116	90.7%	13,378,575	7.7%	2,665,394	1.5%
2020	142,486,378	86.3%	18,422,366	11.2%	4,197,663	2.5%
2021	249,678,041	91.6%	15,732,691	5.8%	7,181,777	2.6%
2022	168,195,069	89.0%	18,663,163	9.9%	2,207,762	1.2%
2023	285,150,516	91.9%	21,097,279	6.8%	4,115,542	1.3%
2024	257,241,298	87.7%	24,120,994	8.2%	12,111,104	4.1%
Total	**1,714,195,299**	**89.1%**	**152,596,342**	**7.9%**	**56,303,160**	**2.9%**

Nga kategoria e mallrave, vetëm 3.4% kanë të bëjnë me pajisjet dhe aparatet mjekësore. Konkretisht, në periudhë prej 10 vitesh, për prokurimin e pajisjeve janë lidhur kontrata me vlerë prej gjithsej 3.6 miliardë denarë, ose 59 milionë euro. Është me rëndësi të theksohet se këtu nuk përfshihen pajisjet, të cilat gjatë periudhës 10-vjeçare janë blerë nëpërmjet kredive nga Banka Botërore (përmes së cilës janë blerë pajisje me vlerë prej më tepër se 1.2 miliardë denarë) ose nga kreditorë të tjerë, për shkak se për prokurimin e tyre janë zbatuar procedurat sipas rregullave të kreditorit.

Sipas gjetjeve në raportet e revizionit, disa pajisje të blera kanë mbetur të papërdorura për shkak të mungesës së personelit ose kushteve të përshtatshme hapësinore, gjë që tregon se prokurimet shpesh janë bërë pa planifikim dhe vlerësim të mjaftueshëm të nevojave reale, përkatësisht prokurimet kanë qenë pikësynimi i vetëm. Kjo krijon një rrezik të lartë për aktivitete korrupsioni dhe keqpërdorim të fondeve publike, veçanërisht për shkak se kreditë në fund të fundit servisohen nga buxheti, pra në kurriz të tatimpaguesve.

Konstatimi se pjesa më e madhe e shpenzimeve për prokurime publike janë për mbulimin e proceseve të punës, kurse jo për investime kapitale (ndërtim dhe rindërtim të objekteve shëndetësore, pajisje, mjete motorike për nevojat e shëndetësisë, etj.) është konfirmuar edhe në botimin e Institutit të Shëndetit Publik. Trendi i treguesve shëndetësorë "shëndet për të gjithë" në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën 2013-2023. Në këtë botim vlerësohet që shpenzimet totale për investime kapitale për institucionet mjekësore si përqindje e shpenzimeve totale shëndetësore në periudhën 2013-2023 shënojnë rënie të vazhdueshme nga 11.99% në vitin 2013 deri 0.8% në vitin 2023.

6 Vlera nuk përfshin kontratat nga Regjistrat e procedurave me kërkesë për oferta.
7 Vlera nuk përfshin kontratat nga Regjistrat e procedurave me kërkesë për oferta.
8 Vlera nuk përfshin kontratat nga Regjistrat e procedurave me kërkesë për oferta.
9 Vlera nuk përfshin kontratat nga Regjistrat e procedurave me kërkesë për oferta.

Shpenzimet totale për investime kapitale për institucionet mjekësore si% e shpenzimeve totale shëndetësore në RMV gjatë periudhës 2013 - 2023

Viti	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Pjesëmarrja	11.99	5.36	4.41	4.89	4.41	4.83	2.4	2.4	1.3	1.07	0.8

Kjo donë të thotë që sistemi i mbrojtjes shëndetësore funksionon në afat të shkurtër, duke i siguruar nevojat e përditshme, mirëpo pa investuar për modernizimin dhe përmirësimin e kushteve të trajtimit mjekësor. Një trend i tillë krijon rrezik për:

- vjetrim dhe funksionalitet të pamjaftueshëm të infrastrukturës shëndetësore,
- qasje të kufizuar në teknologji mjekësore bashkëkohore dhe
- harxhime të zmadhuara në afat të gjatë, sepse investimet e pamjaftueshme sot çojnë në riparime dhe harxhime më të mëdha në të ardhmen.

Ose, thënë më thjesht, po investohet në "shuarje të zjarreve" në vend që të investohet në zhvillim. Kjo e thellon përshtypjen e mungesës kronike të zhvillimit të plotë në sistemin shëndetësor dhe e kufizon aftësinë e tij për t'iu përgjigjur sfidave dhe nevojave të ardhshme të qytetarëve.

Në këtë kontekst, vlen të përmenden edhe gjetjet e revizionit nga raporti i fundit mbi punën e Ministrisë së Shëndetësisë, të cilat tregojnë që, megjithëse janë përfunduar më tepër se 90% e punimeve ndërtimore në Spitalin e Specializuar "Shën Erazmi" në Ohër dhe në Spitalin e Strumicës, e të cilat janë filluar 10 vite më parë, ende nuk janë siguruar kushtet për vënien e tyre në funksion. Gjithashtu në raportet thuhet se janë shpenzuar fonde të konsiderueshme për rindërtimin e spitalit në Kërçovë dhe për ndërtimin e një spitali të ri në Shtip, por ndërtimi ka ngecur, ndërsa punimet tashmë të përfunduara janë të ndjeshme ndaj dëmtimeve për shkak të mospërdorimit dhe mungesës së mirëmbajtjes. Këto kushte ndikojnë negativisht në disponueshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve shëndetësore, krijojnë një ngarkesë shtesë financiare dhe e zvogëlojnë efikasitetin e fondeve publike, ndërkohë që në të njëjtën kohë e zmadhojnë ekspozimin ndaj rreziqeve për korrupsion përmes ndikimeve të mundshme të palejueshme në përzgjedhjen e kontraktorëve, çmimeve dhe menaxhimit të kontratave.

3.1.5. Përqendrimi i prokurimeve publike në ISHP-të në Shkup

Deri në 78% të kontratave për prokurime publike lidhen nga institucionet publike shëndetësore në Shkup. Ky përqendrim i prokurimeve publike në kryeqytet është pjesërisht i kuptueshëm për shkak të madhësisë së institucioneve, por në të njëjtën kohë e imponon nevojën për analiza shtesë mbi arsyeshmërinë, si dhe për mbikëqyrje të zmadhuar mbi konsumatorët më të mëdhenj, me qëllim të parandalimit të korrupsionit dhe keqpërdorimeve.

Nëse bëjmë një kategorizim të institucioneve të mbrojtjes shëndetësore dhe i ndajmë ato në 4 grupe - klinika, Ministria e Shëndetësisë, institucionet tjera publike të mbrojtjes shëndetësore në Shkup dhe institucione publike shëndetësore në të gjitha komunat e tjera në vend, fitojmë një pasqyrë të qartë se ku janë të përqendruara prokurimet publike në vend.

Prokurimet publike në sektorin e shëndetësisë në vitin 2024



Në vlera absolute, në vitin 2024, klinikat kanë lidhur kontrata për prokurime publike me vlerë prej përafërsisht 138 milionë euro. Kjo është një rritje prej 103 milionë euro në një periudhë prej 10 vitesh. Vlera e prokurimeve të tyre është më e lartë se vlera e të gjitha institucioneve tjera publike shëndetësore, nga të cilat, institucionet tjera shëndetësore në Shkup kanë zbatuar tenderë me vlerë prej 45 milionë euro, ndërsa institucionet në të gjitha komunat e tjera deri në 68 milionë euro.

Krahasim i vlerës së prokurimeve publike në vitin 2015 dhe në vitin 2024

Institucioni	2015			2024		
	Vlera (denarë)	Vlera (euro)	Pjesëmarrja	Vlera (denarë)	Vlera (euro)	Pjesëmarrja
Klinikat	2,132,527,863	34,675,250	27.56%	8,470,589,306	137,733,159	43.66%
ISHP-të tjera në Shkup	1,222,806,619	19,883,034	15.80%	2,740,466,200	44,560,426	14.13%
ISHP-të në të gjitha komunat tjera	1,350,168,558	21,953,960	17.45%	4,206,395,474	68,396,674	21.68%
Ministria e Shëndetësisë	3,033,271,143	49,321,482	39.20%	3,982,572,769	64,757,281	20.53%

3.2 KUR TENDERËT ZMADHOHEN, NDËRSA KONKURRENCA REDUKTOHET

3.2.1. Mungesa e konkurrencës përqendron ndikimin midis një grupi të vogël lojtarësh dominues

Rritja e madhe e vlerës së prokurimeve publike në sektorin shëndetësor po pasohet nga një numër gjithnjë e më i vogël i ofertuesve në tenderët. Pothuajse gjysma e vlerës së kontratave është krijuar përmes procedurave të tenderit në të cilat ka pasur vetëm një ofertues. Mungesa e konkurrencës ka potencialin që ta përqendrojë pasurinë dhe ndikimin midis një grupi të vogël lojtarësh dominues dhe të shpie në rritje të çmimeve, ulje të cilësisë së shërbimeve shëndetësore për pacientët dhe reduktim të shumëllojshmërisë së ilaçeve.

Të dhënat tregojnë se për një periudhë prej vetëm pesë vitesh, numri mesatar i ofertave në tenderët në sektorin shëndetësor ka rënë nga 3.30 oferta për tender (viti 2020) në 2.64 oferta (viti 2024). Kjo rënie është më e madhe se në sistemin e përgjithshëm të prokurimeve publike në vend, që sugjeron se sektori i mbrojtjes shëndetësore është posaçërisht i lëndueshëm. Konkurrenca e reduktuar nënkupton më pak furnizues për përzgjedhje, kushte më të dobëta për çmimin dhe cilësinë, dhe rrezik më i madh nga krijimi i një "tregu të mbyllur" i dominuar nga vetëm një ose disa kompani.

Një nga treguesit kryesorë për vlerësimin e rreziqeve nga korrupsioni është pikërisht konkurrenca dhe pjesëmarrja e tenderëve të lidhur me vetëm një ofertues në prokurimet e përgjithshme.

Të dhënat për numrin mesatar të ofertave janë përllogaritur për periudhën 2020 - 2024, më konkretisht për periudhën pas miratimit të Ligjit të ri të Prokurimet Publike. Për periudhën e mëhershme, këto të dhëna nuk mund të shkarkohen tërësisht nga SEPP-ja për arsye se janë pjesë integrale e të ashtuquajturave Evidenca të procedurave me kërkesë për mbledhjen e ofertave.

Konkurrenca në sektorin shëndetësor është gjithmonë më e ulët se konkurrenca e përgjithshme në prokurimet publike në vend. Kështu, nëse në Republikën e Maqedonisë së Veriut numri mesatar i ofertave në periudhën 2020-2024 lëviz nga 3.58 e deri në 2.82, në sektorin shëndetësor ajo mesatare është nga 3.30 në 2.64.

Konkurrenca në prokurimet publike në sektorin shëndetësor

Viti	2020	2021	2022	2023	2024
Numri mesatar i ofertave në sektorin shëndetësor	3.30	3.12	2.88	2.76	2.64
Numri i tenderëve me një ofertë	2,342	2,362	2,513	3,081	3,374
Pjesa e tenderëve me një ofertë	29.9%	30.8%	34.9%	37.1%	39.5%
Vlera e tenderëve me 1 ofertë në euro	61,334,234	118,103,179	88,256,888	174,968,106	161,298,210
Pjesëmarrja e vlerës së tenderëve me 1 ofertë	37.2%	43.3%	46.7%	56.4%	55.0%

Siç mund të shihet nga paraqitja tabelore, numri i tenderëve në të cilët është paraqitur vetëm një ofertë ka pjesëmarrje prej 39.5% në vitin 2024, ndërsa në vlerë arrin deri 55%.

Fakti që gjysma e vlerës së prokurimeve publike në sektorin e mbrojtjes shëndetësore realizohet përmes tenderëve me vetëm një ofertues është një alarm serioz. Kjo krijon kushte për:

- tenderë të zbatuar formalisht, por në thelb të paefektshëm;
- dakordime të mundshme midis institucioneve dhe kompanive; dhe
- rrezik të zmadhuar për favorizim të disa kompanive konkrete përmes kushteve të hartuara në mënyrë të posaçme në tender.

Në bazë vjetore, më tepër se 160 milionë euro fitohen pa konkurrencë. Kjo është një shumë mjaftueshëm e madhe për të ndikuar mbi tërë tregun e prokurimeve në sektorin shëndetësor dhe për ta përqendruar pasurinë dhe pushtetin tek një numër të vogël kompanish. Një përqendrim i tillë krijon hapësirë për "oligarkizimin" e prokurimeve publike dhe "kapjen" e institucioneve nga grupet e interesit. Konkurrenca e reduktuar dhe përqendrimi i lartë sjellin jo vetëm rrezikun për korrupsion, por edhe pasoja të drejtpërdrejta për pacientët:

- çmime më të larta të ilaçeve dhe materialeve,
- shumëllojshmëri dhe disponueshmëri e reduktuar e produkteve,
- potencial për cilësi më të ulët të shërbimeve dhe
- inovacion i ngadalësuar, sepse kompanitë nuk kanë nxitje për t'u përmirësuar kur konkurrenca është e vogël.

Trendi i rritjes së prokurimeve me vetëm një ofertues është një nga treguesit më të fortë të rritjes së rrezikut për korrupsion në sektorin shëndetësor. Në vend që tenderët të sigurojnë çmimin dhe cilësinë më të favorshme përmes konkurrencës midis më tepër ofertuesve, ato po shndërrohen në një mekanizëm për transferimin e fondeve publike te një rreth i kufizuar aktorësh ekonomikë. Kjo jo vetëm që shkel integritetin e sistemit, por edhe rrezikon besimin e qytetarëve në institucionet e mbrojtjes shëndetësore.

3.2.2. Mungesa e konkurrencës në prokurimin e reagensëve, testeve dhe materialeve për testime laboratorike

Tenderët për prokurimin e reagensëve dhe testeve janë kryesisht vetëm një formalitet sepse ato zhvillohen për ndonjë aparat, përzgjedhja e të cilit tashmë është punë e kryer, që donë të thotë se edhe para se të fillojë procedura, është e qartë se kush do ta fitojë tenderin. Aparatet janë paraprakisht të fituara si donacione, janë marrë për përdorim nga kompanitë që shesin reagensë ose janë blerë. Prokurimet për reagensë dhe teste në nivel vjetor arrijnë vlerën deri në 29 milionë euro. Për 10 vjet, shpenzimet për reagensë dhe teste janë zmadhuar deri me 81%.

Prokurimi i testeve dhe reagensëve në periudhë prej 10 vitesh është zmadhuar nga rreth 16 milionë euro në rreth 29 milionë euro.

Vlera e prokurimeve publike për reagensë dhe teste

Viti	Vlera në denarë	Vlera në euro	Ndryshimi
2015	977,682,529	15,897,277	/
2016	772,163,898	12,555,511	-21.02%
2017	742,899,015	12,079,659	-3.79%
2018	659,219,730	10,719,020	-11.26%
2019	885,231,495	14,394,008	34.28%
2020	1,164,549,271	18,935,761	31.55%
2021	1,440,022,632	23,415,002	23.65%
2022	1,375,124,867	22,359,754	-4.51%
2023	1,603,413,130	26,071,758	16.60%
2024	1,766,838,757	28,729,085	10.19%

Për t'u detektuar ndikimi i inflacionit, është bërë një krahasim i çmimeve të reagensëve dhe testeve që janë përcaktuar në vitin 2022 dhe në vitin 2024. Është vërejtur që te disa kategori çmimet janë të pandryshuara, ndërsa te disa prej tyre, rritjet janë konsiderueshëm nën nivelin e inflacionit.

Rritja e vazhdueshme e shpenzimeve për blerjen e reagensëve dhe testeve nuk e zmadhoi përgjegjësinë e institucioneve publike shëndetësore që t'i zbatojnë prokurimet e reagensëve dhe testeve në mënyrë konkurruese, as për t'iu përmbajtur rekomandimeve të Entit Shtetëror për Revizion, të cilat i ka përgatitur 10 vjet më parë.

Siç mund të shihet, në periudhën e 5 viteve të fundit për të cilat ka të dhëna të sakta për konkurrencën, pjesëmarrja e tenderëve me 1 ofertë lëviz midis 70% dhe 80%.

Kontrata të lidhura për prokurimin e reagensëve dhe testeve në bazë të një oferte të vetme 2020 - 2024

Viti	Vlera e tenderëve me vetëm 1 ofertë në denarë	Vlera e kontratave me vetëm 1 ofertë në euro	Pjesëmarrja e tenderëve me 1 ofertë
2020	934,586,352	15,196,526	80.3%
2021	1,023,839,092	16,647,790	71.1%
2022	1,044,358,388	16,981,437	76.0%
2023	1,252,040,745	20,358,386	78.1%
2024	1,301,812,067	21,167,676	73.7%

Duke marrë parasysh se institucionet që kanë pasur kontratat më të larta individuale për prokurimin e reagensëve dhe testeve janë: Instituti Universitar i Biokimisë Klinike - Shkup dhe Instituti i Mjekësisë Transfuzive, prej tyre është kërkuar të dorëzojnë të dhënat se si i kanë fituar aparatet për të cilat prokurojnë reagensë.

Bazuar në të dhënat e paraqitura, mund të konstatohet që disa nga aparatet janë fituar në bazë të marrëveshjeve për bashkëpunim teknik-afarist dhe me donacione. Për më tepër, në marrëveshjet qartë është e cekur se institucionet publike shëndetësore janë të detyruara të prokurojnë reagensë dhe materiale të harxhueshme të përshtatshme, gjë që tregon se dhënësi i aparatit përfiton drejtpërsëdrejti nga kjo. Praktika e lartpërmendur nuk korrespondon me dispozitat e Ligjit për Donacionet dhe Sponsorizimet në Veprimtaritë Publike, ku donacioni është i përkufizuar si "ndihmë vullnetare dhe e pakushtëzuar me para, mallra dhe shërbime që nuk krijon përfitim të drejtpërdrejtë për dhënësin e donacionit ose ndonjë detyrim për t'u kthyer donacioni nga pranuesi i donacionit dhe se mund të jepet për qëllime me interes publik ose për përkrahje të aktiviteteve të pranuesit të donacionit".

Kjo situatë është konstatuar nga Enti Shtetëror për Revizion që nga viti 2015 gjatë revizionit të kryer në punën e Institutit Universitar të Biokimisë Klinike. Në raport është konstatuar që në shumicën e procedurave të zbatuara për tender për prokurim të reagensëve, materialeve laboratorike dhe materialeve tjera të harxe hueshme është parashtruar vetëm një ofertë. Prandaj, ESHR-ja vlerëson: "Arsyeja që është parashtruar vetëm një oferte është fakti që në specifikimet në tender janë cekur reagensët për aparate konkrete, ndërsa secili aparat mund të përdor reagensë vetëm nga prodhuesi/përfaqësuesi nga i cili janë blerë. Me qëllim të përi-gatitjes së analizave-testeve laboratorike, përveç reagensëve, gjithashtu të nevojshëm janë edhe reagensë për kalibrim dhe kontroll dhe materiale të harxhueshme, për të cilat Klinika bën shpenzime shtesë. Metoda e vendosur e zbatimit të prokurimit të reagensëve për analiza laboratorike nuk lejon përdorimin adekuat të fondeve në procedurat për ndarjen e kontratave për prokurime publike, gjë që nuk është në përputhje me nenin 2 të Ligjit për Prokurime Publike. Për sa i përket kësaj situate të konstatuar, ESHR-ja rekomandon: "Organet drejtuese dhe udhëheqëse duhet të ndërmarrin aktivitete për ta ndryshuar metodën e vendosur të prokurimit të reagensëve që janë të dedikuar për aparate konkrete dhe të mundësojnë konkurrencë nëpërmjet prokurimit të testeve laboratorike për të gjitha llojet e analizave, duke përfshirë reagensët, kalibrimin, kontrollin dhe materialet e harxhueshme, si dhe aparatet (analizatorët) dhe pajisjet shtesë".

Një gjetje e tillë është prezantuar edhe në raportin e revizionit për Institutin e Shëndetit Publik - Instituti i Mjekësisë Transfuzive të publikuar në vitin 2018. Në të thuhet: "Procedurat e zbatuara të prokurimeve publike zbatohen vetëm

formalisht duke e pasur parasysh pamundësinë e operatorëve të tjerë ekonomikë për t'u paraqitur si ofertues në procedurë dhe në këtë mënyrë nuk bëhet ulje e çmimit përmes ofertave elektronike, përkatësisht pranohet çmimi që është dhënë në ofertë. Në këtë mënyrë, ISHP - Instituti i Mjekësisë Transfuzive nuk mbrohet nga mundësia që operatori ekonomik të ofrojë çmime më të larta nga ato të tregut dhe në këtë mënyrë krijohen rreziqe mbi përa dorimin racional dhe efikas të fondeve në përputhje me nenin 2 të Ligjit për Prokurime Publike". Edhe në këtë raport theksohet se është e nevojshme që ISHP-ja t'i forcojë përpjekjet e tij për të arritur çmime reale të tregut dhe konkurë rencë në procedurat e prokurimeve publike, duke i respektuar mundësitë ligjore që i ofron Ligji për Prokurime Publike.

Megjithatë, pavarësisht këtyre gjetjeve të ESHR-së dhe rekomandimeve të prezantuara, nuk mund të vërehet përparim, përkundrazi, shpenzimet për reagensë po rriten, ndërsa në të shumtën e rasteve tenderët janë vetëm një formalitet. Këto gjetje mund t'i detektojmë në pothuajse çdo institucion publik shëndetësor që i është nënshtruar revizionit viteve të fundit.

Gjatë kësaj, ndërsa shpenzimet për reagensë dhe teste po rriten, pacientët shpesh postojnë fotografi në mediat sociale nga të cilat mund të shihet se institucionet e mbrojtjes shëndetësore shpesh informojnë për mungesë të reagensëve.

Foto të postuara në rrjetet sociale më 25 korrik 2025

Fotografia e anës së majtë: [përkthim] Nuk kemi reagentë për antigjenin helicobacter pylori (në feçe)/ Nuk kemi reagentë për Pneumoslide. Fotografia e anës së djathtë: [përkthim] NJOFITIM: Nuk kemi reagentë për AST, CRP dhe RF në serum për shkak të ndërprerjes së prodhimit nga furnizuesi/ Nuk kemi reagentë për EBV, gjak okult (në feçe), AVIDITY-ANTI-CMV.

Në raportin vjetor të FSSHM-së për vitin 2015 thuhet se numri i përgjithshëm i shërbimeve laboratorike të kryera në institucionet private të mbrojtjes shëndetësore është 5,235,724. Në këtë raport, nuk ka të dhëna të tilla për vitet e fundit që të shohim nëse rritja e shpenzimeve për reagensët është e shoqëruar me rënie të numrit të shërbimeve të ofruara nga shërbimet private të kujdesit shëndetësor. Mungesa e të dhënave sugjeron në rrezik për praninë e një trendi të kundërt.

Duke i pasur parasysh të gjitha këto, mund të konstatojmë që sistemi i prokurimit të reagensëve dhe testeve është një shembull i "lëndueshmërisë strukturore ndaj korrupsionit" - tenderët zhvillohen pa konkurrencë të vërtetë, pavarësisht faktit se institucionet e revizionit prej kohësh e kanë vënë në dukje problemin. Rritja e shpenzimeve, mungesa e konkurrencës dhe varësia nga disa furnizues të caktuar krijojnë një treg të mbyllur, në të cilin institucionet publike shëndetësore nuk kanë fuqi negociuese, ndërsa qytetarët paguajnë kosto më të larta.

Nëse e marrim parasysh faktin që ende nuk është themeluar Sistemi Nacional për Punën Materiale në Shëndetësinë Publike, si një detyrim ligjor i paraparë që nga viti 2015 dhe që shteti përmes Ministrisë nuk e monitoron dhe nuk e kontrollon konsumin e ilaçeve, reagensëve dhe materialeve tjera mjekësore për çdo pacient në ISHP, ekziston një rrezik i lartë për keqpërdorimin e tyre, apo me fjalë tjera, ilaçet dhe reagensët të përfundojnë në spitale dhe laboratorë privatë.

3.3 INSULINA, VAKSINAT DHE ILAÇET PËR SËMUNDJE TË RRALLA: ME TEPËR PARA NË PROGRAMET E MBROJTJES SHËNDETËSORE, POR JO EDHE KUJDES ME I MIRË PËR PACIENTËT

Ministria e Shëndetësisë ka rreth 20 programe për mbrojtje shëndetësore çdo vit, nga të cilat më të mëdha për nga aspekti i vlerës së prokurimeve publike janë (1) Programi për sigurimin e insulinës, glukagonit, gjilpërave të insulinës dhe shiritave për matjen e sheqerit në gjak, pompave të insulinës me materiale të harxhueshme dhe sensorëve për matjen e vazhdueshme të glicemisë, (2) Programi për imunizimin e detyrueshëm të popullatës dhe (3) Programi për trajtimin e sëmundjeve të rralla. Për zbatimin e këtyre programeve, janë themeluar komisione nacionale ekspertësh mjekësorë, të cilët i zhvillojnë specifikimet teknike dhe përcaktojnë sasitë që do të prokurohen. Me hulumtimin është zbuluar një numër dobësish në zbatimin e atyre programeve në aspektin e prokurimeve publike.

3.3.1. Prokurimi i ilaçeve dhe materialeve të harxhueshme për trajtimin e diabetit

Tenderët për prokurimin e insulinës, glukagonit, gjilpërave të insulinës dhe shiritave për matjen e sheqerit në gjak, pompave të insulinës dhe sensorëve matës të glicemisë që arrijnë vlerën deri 39 milionë euro për një periudhë dyvjeçare zbatohen në procedura në të cilat nuk ka konkurrencë, ndërkaq, kontratat e lidhura madje plotësohen. Për një periudhë prej 10 vitesh, numri i pacientëve në terapi me insulinë është rritur për 21%, ndërsa vlera e kontratave për 77%. Programet për prokurimin e insulinës po shkurtohen nga viti në vit, kurse raportet për realizimin e programeve nuk publikohen rregullisht dhe mungon llogaridhënie publike për mjetet e shpenzuara.

Tenderët për prokurimin e insulinës, glukagonit, gjilpërave të insulinës dhe shiritave për matjen e sheqerit në gjak, pompave të insulinës dhe sensorëve matës të glicemisë (në tekstin e mëtejmë të referuara si ilaçet dhe materiale të harxhueshme për trajtim të diabetit), gjatë këtyre 10 viteve të fundit zbatohen për një periudhë dyvjeçare. Së këtejmi, procedurat e tenderimit në periudhën e analizuar 2015 - 2024 janë publikuar në vitet 2015, 2017, 2019, 2021, 2023.

Në vitin 2015, në përputhje me Programin për sigurimin e insulinës, glukagonit, gjilpërave të insulinës, shiritave për matjen e sheqerit në gjak dhe edukimin për trajtimin dhe kontrollin e diabetit, numri i individëve të regjistruar me diabet, të cilët janë në terapi me insulinë ka qenë 36,230 persona, nga të cilët 2,230 janë persona me diabet të tipit 1 dhe rreth 34,000 persona me diabet të tipit 2.

Pas 10 vitesh, përkatësisht në vitin 2024, numri i personave të regjistruar me diabet, të cilët janë në terapi me insulinë në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka qenë 44,000 persona, nga të cilët 4,000 janë persona me diabet tip 1 dhe 40,000 persona me diabet tip 2. Ky trend sugjeron në rritje të numrit të pacientëve për 21.44%. Megjithatë, me hulumtimin zbulohet se vlera e tenderëve është zmadhuar për 76.84%.

Vlera e ofertave për trajtimin e pacientëve që janë me terapi me insulinë

Periudha	Numri i pacientëve në terapi me insulinë	Rritja e numrit të pacientëve[10]	Vlera e tenderëve pas aneksimit të kontratave të nënshkruara, në denarë	Vlera e ofertave pas aneksimit të kontratave të nënshkruara, në euro	Ndryshimi në raport me vlerën e ofertave
2015-2016	36,230	0	1,356,561,287	22,057,907	/
2017-2018	40,000	10.41%	1,166,697,639	18,970,693	14.00%
2019-2020	40,000	0	1,648,735,721	26,808,711	41.32%
2021-2022	40,000	0	1,882,558,130	30,610,701	14.18%
2023-2024	44,000	10.00%	2,398,973,793	39,007,704	27.43%

Dallimet dhe ngjashmëritë në mënyrën e prokurimit të insulinës, glukagonit, gjilpërave të insulinës dhe shiritave për matjen e sheqerit në gjak, pompave të insulinës me materiale të harxhueshme dhe sensorëve për matjen e vazhdueshme të glicemisë gjatë periudhës 10-vjeçare mund të shihen më së miri nëse i krahasojmë tenderët e zbatuar për të mbuluar nevojat e pacientëve në periudhën 2015-2016 dhe 2023-2024, pra në dy vitet e para dhe dy vitet e fundit të periudhës së analizuar.

Prokurimi i ilaçeve dhe materialeve të harxhueshme për trajtimin e diabetit për periudhën gusht 2014 - gusht 2016 është kryer në vetëm një procedurë tenderimi. Bëhet fjalë për një tender të Ministrisë së Shëndetësisë me numrin serik 36/2014, i zbatuar në periudhën shtator - nëntor të vitit 2014. Bazuar në këtë tender, janë lidhur 7 kontrata me vlerë totale prej 1,356,561,287 denarë, përkatësisht 22 milionë euro.

Përkundër kësaj, për periudhën janar 2023 - dhjetor 2024, janë lidhur gjithsej 12 kontrata për prokurime publike për ilaçe dhe materiale të harxhueshme për trajtimin e diabetit dhe 5 aneks-kontrata, me gjithsej 7 kompani, vlera e të cilave arriti shumën prej 2,398,973,793 denarë, apo 39 milionë euro.

- 6 kontratat e para janë lidhur në prill të vitit 2023 bazuar në procedurën e tenderimit me numër serik 01046/2023 të titulluar "Insulinë dhe glukagon, për periudhën janar 2023 - dhjetor 2024 për nevojat e popullsisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut". Kontratat u lidhën me 6 kompani në vlerë totale prej 1,708,463,075 denarë. Përveç kësaj, ka një vonesë të dukshme në kontratat prej gati 4 muajsh nga periudha për të cilën ato janë paraparë.

10 Të dhënat janë marrë nga programet për sigurimin e insulinës, glukagonit, gjilpërave të insulinës dhe shiritave për matje të glukozës, pompave të insulinës me materiale të harxhueshme dhe sensorëve për matjen e vazhdueshme të glicemisë.

- Pastaj, në korrik të vitit 2023, janë lidhur 3 kontrata për prokurimin e gjilpërave të insulinës dhe shiritave për matjen e sheqerit në gjak, pompave të insulinës me materiale të harxhueshme dhe sensorëve për matje të vazhdueshme të glicemisë për periudhën janar 2023 - dhjetor 2024 për nevojat e popullsisë së Republikës së Maqedonisë në procedurën e tenderimit me numër 05992/2023. Vlera totale e këtyre kontratave është 202,535,560 denarë.
- Gjatë muajit gusht të vitit 2023, janë lidhur edhe dy kontrata të tjera për prokurimin e sistemeve për monitorim të glukozës me sensorë të dedikuar për pacientët me diabet tip 1 në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për periudhën prill 2023 - prill 2025. Kontratat janë lidhur në vlerë totale prej 194,020,320 denarë edhe atë përmes procedurës së tenderimit me numër serik 09730/2023.
- Në fund të muajit gusht 2023, për periudhën 2023 – 2024, është lidhur edhe një kontratë tjetër për prokurim të insulinës për nevojat e popullsisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, në vlerë totale prej 62,685,000 denarë. Kjo është një kontratë e lidhur përmes një procedure tenderimi me numër rendor serik 13899/2023.
- Në muajin prill dhe muajin maj të vitit 2024, bëhet publikimi i një njoftimi për 4 anekse të lidhura të kontratave nga tenderi me numër serik 01046/2023, ndërsa në prill të vitit 2025, pason edhe aneks-kontrata e pestë. Përmes këtyre anekseve, vlera e kontratave është zmadhuar për 231,269,839 denarë, që paraqet 13.54% të vlerës totale të të gjitha kontratave nga ky tender. Në këtë mënyrë, vlera totale e tenderit me numër serik 01046/2023 arrin shumën prej 1,939,732,914 denarë. Për 4 anekset e para, është prezantuar arsyetimi se ato janë nënshkruar për shkak të numrit të rritur të pacientëve të rinj që janë përfshirë në trajtimin me këto insulina, si dhe për shkak të rritjes së dozave për rregullimin e glicemisë te një numër i caktuar pacientësh. Aneksi i pestë arsyetohet se është nënshkruar për shkak të faktit se konsumi i dy llojeve të insulinës (Pjesa 2 – FIASP FlexTouch 100E/1 ml dhe Pjesa 16 – TRESIBA FLEXTOUCH 100E/1ml) është rritur për më tepër se 20% dhe nevojitet prokurim i sasive shtesë. Për nënshkrimin e aneks-kontratave është siguruar mendim pozitiv nga Komisioni Nacional për Diabet dhe nga Personi Përgjegjës për menaxhimin e programit për sigurimin e insulinës, glukagonit, gjilpërave të insulinës dhe shiritave për matjen e glukozës, pompave të insulinës me materiale konsumuese dhe sensorëve për matjen e vazhdueshme të glicemisë.

Numri i madh i procedurave të zbatuara për prokurime publike të ilaçeve dhe materialeve të harxhueshme për trajtimin e diabetit, si dhe numri i madh i kontratave të ndara dhe aneksimet e nënshkruara të atyre kontratave, sugjerojnë në dobësi gjatë planifikimit të periudhës kohore për të cilën zbatohen prokurimet dhe përcaktimi joadekuat i llojeve dhe sasive të ilaçeve që nuk i plotësojnë nevojat e pacientëve, veçanërisht duke e pasur parasysh që disa nga sasitë harxhohen me intensitet më të madh, ndërsa disa nga sasitë mbeten të pakonsumuara. Këto situata krijojnë rrezik për sigurimin e pamjaftueshëm dhe jo me kohë të terapisë së nevojshme.

3.3.2. Prokurimi i vaksinave për imunizimin e popullsisë

Tenderët për vaksinimin e popullsisë po bëhen gjithnjë e më të shtrenjtë, ndërsa prokurimet e zbatuara në disa vite të caktuara janë të karakterizuara me dobësi - nga faza e planifikimit deri te dështimi për të lidhur kontrata.

Nevojitet të bëhen kërkime të gjata nëpër Sistemin Elektronik për Prokurimet Publike dhe analizë e të gjitha kontratave për prokurime publike për imunizimin e popullsisë për t'i sistematizuar ato sipas tenderëve dyvjeçarë dhe trevjeçarë. Problemet fillojnë me publikimin me vonesë të shpalljeve për prokurime publike. Më konkretisht:

- tenderi për prokurimin e vaksinave për imunizim të vazhdueshëm dhe vaksinave sipas treguesve epidemiologjikë për nevojat e popullsisë për periudhën qershor 2016 - qershor 2018 - shpallja është publikuar në tetor 2016, ndërsa kontratat janë lidhur në janar dhe shkurt të vitit 2017.
- vonesa ka pasur edhe në prokurimet e vaksinave për periudhën nga qershori 2018 deri në qershor 2020, si dhe për periudhën nga janari i vitit 2021 deri në dhjetor të vitit 2023.

Për më tepër, është vërejtur se në prokurimet e zbatuara për periudhat qershor 2016 - qershor 2018, për qershor 2018 - qershor 2020, si dhe për periudhën aktuale (janar 2024 - dhjetor 2026), disa pjesë të prokurimit të vaksinave individuale janë anuluar. Për pjesët e anuluara sërish janë publikuar shpallje, por për disa nga vaksinat sërish nuk është paraqitur asnjë ofertë ose asnjë ofertë nuk ka qenë e pranueshme. Është e pamundur të gjenden kontrata të lidhura në SEPP për pjesët që janë anuluar më parë gjatë prokurimeve dhe kjo e ngre pyetjen se si është bërë vaksinimi i popullatës për ato lloje të posaçme të vaksinave. Tenderi për prokurimin e vaksinave për imunizimin e popullatës për periudhën janar 2024 - dhjetor 2026 fillimisht nuk ka qenë pjesë e Planit për prokurime publike të vitit 2023, por është përfshirë me ndryshimet dhe prokurimi është zbatuar. Megjithatë, ashtu si në shumicën e tenderëve të mëparshëm, nga 22 lloje vaksinash, për 8 lloje nuk është parashtruar asnjë ofertë ose asnjë ofertë nuk ka qenë e pranueshme, ashtu që për ato pjesë të prokurimeve, në shtator të vitit 2023 është sjell vendim për t'i anuluar. Shpallja e re për pjesët e anuluara të prokurimeve nuk është publikuar menjëherë, por është publikuar më 29 dhjetor të vitit 2023. Në procedurën e përsëritur, janë lidhur kontrata për 6 pjesë të tenderit, ndërsa për dy pjesët tjera sërish ka pasuar anulim i procedurës.

Kontratat për prokurime publike për imunizim të vazhdueshëm dhe imunizim sipas indikacioneve epidemiologjike të popullatës

Lënda e kontratës	Data e lidhjes së kontratave	Vlera e kontratave në denarë	Vlera e kontratave në euro
Vaksina për vitin 2015 dhe 2016 (tenderi nr. 87/2015)	17.12.2015	241,314,165	3,923,808
Vaksina për periudhën nga qershori 2016 deri në qershor 2018 (tenderi nr. 79/2016)	23.1.2017	309,546,073	5,033,269
3.2.2017	309,546,073	5,033,269	163,902
Vaksina për periudhën nga qershori 2016 deri në qershor 2018 (tenderi nr. 13/2017)	20.10.2017	10,080,000	163,902
Vaksina për periudhën nga qershori 2018 deri në qershor 2020 (tenderi nr. 59/2018)	20.06.2019	98,220,586	1,597,083
6.3.2019	591,045,920	9,610,503	15,141,140
Vaksina për periudhën nga qershori 2018 deri në qershor 2020 (tenderi nr. 35/2019)	20.6.2019	98,220,586	1,597,083
Vaksina për periudhë 3-vjeçare: janar 2021 deri në dhjetor 2023 (tenderi nr. 02000/2021)	14.6.2021	931,180,131	15,141,140
Vaksina për periudhë 3-vjeçare: janar 2024 deri në dhjetor 2026 (tenderi nr. 11344/2023)	4-6.9.2023	833,566,188	13,553,922
Vaksinat për periudhë 3-vjeçare: janar 2024 deri në dhjetor 2026 (tenderi nr. 23856/2023)	7.3.2024	241,507,903	3,926,958

Dinamika e papërshtatshme kohore me të cilën janë zbatuar tenderët për prokurimin e vaksinave është paraqitur në tabelën më sipër. Përveç kësaj, sa u përket këtyre prokurimeve, është me rëndësi të theksohet që rritja e vlerës së këtyre tenderëve është jashtëzakonisht e madhe. Për periudhën e fundit trevjeçare janar 2024 - dhjetor 2026, për vaksinim janë lidhur kontrata për prokurime publike me vlerë prej afro 1.1 miliard denarë, ose 17.5 milionë euro.

Situatat që kanë të bëjnë me dobësitë në planifikimin e periudhës në të cilën do të zbatohen procedurat e prokurimeve publike, numri i madh i pjesëve të anuluara të specifikimeve teknike, si dhe procedura e zgjatur e lidhjes së kontratave sugjerojnë për planifikim dhe përcaktim të papërshtatshëm të sasive në procedurat e prokurimeve publike, si dhe për subjektivizëm në mënyrën se si ato zbatohen dhe kjo lë hapësirë për aktivitete korrupsioni.

Në këtë seksion, duhet të theksohet që në Raportin për realizimin e Programit për vaksinim të detyrueshëm për vitin 2023, të publikuar nga Instituti i Shëndetit Publik, mbulimi i arritur gjatë vaksinimit primar dhe rivaksinimit, varësisht nga lloji i vaksinës, lëviz nga 56.3% në 87.7% të popullatës, që është shumë më poshtë nga synimi bazë i programit, i cili parasheh arritje të mbulimit prej 95% në nivel shtetëror dhe mbulim prej 90% në nivel rajonal me të gjitha vaksinat. Edhe pse Ministria e Shëndetësisë është e detyruar të sigurojë vaksinë për çdo qytetar, përqindja e ulët e vaksinimit krijon rrezikun që disa nga vaksinat të skadojnë ose të pësojnë dëmtime, gjë që ndikon në përdorimin racional të fondeve në procedurat e prokurimeve publike.

3.3.3. Prokurimi i ilaçeve për sëmundjet e rralla

Shpenzimet për ilaçet për sëmundjet e rralla është rritur nga 90 milionë denarë në 1 miliard denarë (ose nga 1.5 në 19 milionë euro) në dekadën e fundit. Kjo rritje e madhe po ndodh në një kohë kur Enti Shtetëror i Revizionit e bën të ditur faktin se Ministria e Shëndetësisë nuk ka të dhëna të plota nëse terapitë vërtetë e përmirësojnë shëndetin e pacientëve. Arsyeja është se për shumicën e sëmundjeve për të cilat prokurohen ilaçe, nuk zhvillohet vlerësim siç është paraparë me Programin për trajtimin e sëmundjeve të rralla.

Qëllimi kryesor i Programit për Trajtimin e Sëmundjeve të Rralla është të ofrohet terapi për personat me sëmundje të rralla, të cilët janë të përfshirë në Regjistrin e Sëmundjeve të Rralla në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për trajtimin e të cilave ekziston leje nga Komisioni Nacional për Sëmundje të Rralla pranë Ministrisë së Shëndetësisë.

Programi i parë i miratuar në periudhën e analizuar, më saktësisht në vitin 2015, përfshinte vlerën prej 90 milionë denarë, por vlera e ilaçeve të prokuruara për sëmundje të rralla ishte rreth 145 milionë denarë, pra 2.3 milionë euro. Dallime ka edhe në vitet tjera. Nga njoftimet e publikuara për realizimin e programeve, nuk ka se si të shihet përse është ky dallim. Në raportet për realizimin e programeve thuhet se programet janë realizuar me shumat e planifikuara, që është më pak se vlera. Megjithatë, nëse i shqyrtojmë raportet për kontratat e realizuara të prokurimeve publike, fitojmë një grup të tretë të shumave. Për shembull, programi i fundit është planifikuar me shumë prej 1 miliard denarë dhe bazuar në raportin, është realizuar me atë shumë. Nga ana tjetër, vlera e kontratave të lidhura është 1,183,711,799 denarë, përkatësisht 19,247,346 euro. Ndërkaq, shuma e tretë del nëse largohen shumat nga njoftimet për kontratat e zbatuara. Bazuar në realizimin, rezulton se për trajtimin e sëmundjeve të rralla janë prokuruar ilaçe në vlerë prej 1,064,864,039 denarë, përkatësisht 17,3 milionë euro.

Vlera e programeve për trajtimin e sëmundjeve të rralla dhe vlera e ilaçeve të prokuruara

Viti	Numri i ilaçeve	Numri i pacientëve	Vlera e programit	Procedurat e tenderimit dhe kontratat e lidhura	Vlera e kontratave për Prokurime Publike në denarë	Vlera e kontratave për Prokurime Publike në euro
2015	/	/	90,000,000	30/2015	144,862,372	2,355,486
2016	/	/	203,000,000	107/2015 34/2016 66/2016	367,942,668	5,982,808
2017	34	146	213,967,000	8/2017 16/2017 Annex contacts signed under direct negotiations without call for bids	133,144,107	2,164,945
2018	23	134	350,093,000	4/2018 Annex contacts signed under direct negotiations without call for bids	371,789,716	6,045,361
2019	31	170	407,880,000	6/2019 03755/2019 15359/2019	462,143,192	7,514,523
2020	35	183	522,000,000	04956/2020 11338/2020 15359/2019	541,396,589	8,803,197
2021	43	245	680,000,000	05653/2021 10919/2021 12532/2021	637,746,481	10,369,861
2022	44	286	657,000,000	06151/2022 14752/2022	614,411,030	9,990,423
2023	49	313	878,000,000	01183/2023	989,159,800	16,083,899
2024	50	376	1,000,000,000	20518/2023 02867/2024 08048/2024 14797/2024	1,183,711,799	19,247,346

Kjo rritje e madhe e vlerës së ilaçeve të prokuruara për sëmundjet e rralla, edhe atë deri në 10 herë, në një periudhë prej 10 vitesh ndodh kur Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) bën një zbulim shqetësues. Në raportin të publikuar këtë vit, ESHR ka ardhur në përfundimin se nuk janë kryer aktivitete vlerësimi për shumicën e sëmundjeve për të cilat sigurohen ilaçe siç është e paraparë me Programin. Komisione janë formuar vetëm për dy sëmundje të rralla, ndërkaq vlerësim është kryer vetëm për një sëmundje që nuk është në përputhje me nenin 7 të Rregullores për Punë të Komisionit Nacional për Sëmundje të Rralla, me të cilin parashihet formimi i komisioneve të posaçme për vlerësimin e efekteve të terapive të pacientëve, të paktën një herë në vit. Për shkak të sipërpërmendurës, Enti Shtetëror i Revizionit vlerëson se Ministria e Shëndetësisë nuk ka të dhëna të plota për atë nëse dhe në çfarë mase terapia ka ndikim pozitiv mbi gjendjen shëndetësore të pacientëve. Kjo është veçanërisht e rëndësishme, duke e pasur parasysh shumën e fondeve të alokuara për këtë program dhe ilaçet që prokurohen rishtazi. Gjithashtu, nuk janë ndërmarrë aktivitete për të siguruar raporte të rregullta nga ISHP-të mbi sasinë e ilaçeve të harxhuara dhe rezervat aktuale të tyre, siç është paraparë me Programin, arsye për të cilën, para krijimit të Modulit në sistemin "Termini Im", nuk është vendosur kontroll dhe monitorim efikas mbi rezervat aktuale të këtyre ilaçeve.

Për më tepër, në raportet e revizionit për disa nga Institucionet Shëndetësore Publike thuhet se përzgjedhja e llojit të ilaçit dhe sasive të tij nuk është me propozim të bordit të ekspertëve të institucionit, siç është paraparë me Ligjin për Mbrojtjen Shëndetësore, përkatësisht ky vendim më së shpeshti sillet nga personat përgjegjës (drejtorët), gjë që lë hapësirë për subjektivitet në përzgjedhjen e ilaçit, si dhe favorizim të prodhuesve dhe farmacive konkrete që punojnë me shumicë.

Për sa u përket dobësive të procesit, edhe këtu është vënë re plotësim i kontratave për prokurime publike me arsyetimin se ka të regjistruar pacientë të rinj.

3.3.4. Llogaridhënie për realizimin e programeve

Mungesë në rregullshmërinë e publikimit të programeve me shtrirje të gjerë financiare në faqen e internetit të Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe raportet mbi zbatimin e tyre.

Raportet për realizimin e programeve për sigurimin e insulinës, glukagonit, gjilpërave të insulinës dhe shiritave për matjen e sheqerit në gjak, pompave të insulinës me materiale të harxhueshme si dhe të sensorëve për matjen e vazhdueshme të glicemisë për vitet 2024 dhe 2023 nuk janë publikuar fare. Raporti i fundit i publikuar në faqen e internetit të Ministrisë së Shëndetësisë është për vitin 2022. Mungesë në rregullshmërinë e publikimit të raporteve është detektuar edhe në programet për imunizimin e detyrueshëm të popullsisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Raporti për zbatimin e këtij programi për vitin 2024 nuk është publikuar.

Përveç raporteve të zbatimit, për disa vite, në faqen e internetit të Ministrisë mungojnë edhe tekstet e programeve. Programet për trajtimin e sëmundjeve të rralla për vitet 2022 dhe 2023 nuk janë publikuar në faqen e internetit të Ministrisë së Shëndetësisë, ndërsa programi për sigurimin e insulinës, glukagonit, gjilpërave të insulinës dhe shiritave për matjen e sheqerit në gjak, pompave të insulinës me materiale të harxhueshme dhe sensorëve për matjen e vazhdueshme të glicemisë nuk është publikuar për vitin 2023.

Por, gjithsesi, të gjitha programet publikohen detyrimisht në Gazetën Zyrtare.

Mungesa e raporteve të rregullta dhe të detajuara ndikon drejtpërdrejt te pacientët: nuk ka mundësi për të vlerësuar nëse ilaçet dhe mjetet ndihmëse mjekësore sigurohen në kohën e duhur, nëse ka ndërprerje në furnizim, e as nëse shpenzimet janë të arsyetuara nga nevojat reale.

Në mjedise ku transparenca është e kufizuar, rritja e shpenzimeve pa rezultate të përmirësuara, në mënyrë të pashmangshme ngre dyshime për korrupsion ose keqmenaxhim.

3.4 DOBËSI NË KAPACITETET E RESURSEVE NJERËZORE DHE MEKANIZMAT PËR MBIKËQYRJE

3.4.1. Kapacitetet e resurseve njerëzore

Një nga faktorët e korrupsionit është mungesa e personelit mjaftueshëm të kualifikuar për zbatimin e prokurimeve. Sipas hulumtimit rezulton që nga 110 institucionet shëndetësore, në 23 prej tyre nuk ka asnjë person që e ka dhënë provimin për prokurime publike, gjë që është në kundërshtim me Ligjin për Prokurime Publike.

Në sektorin shëndetësor, disa nga institucionet publike shëndetësore menaxhojnë me buxhete të mëdha, ndërsa disa nga ato nuk kanë personel të mjaftueshëm të certifikuar për prokurime publike. Kjo është një "mangësi sistemike" sepse prokurimet i kryejnë individë pa ekspertizën ose mbikëqyrjen e duhur, gjë që krijon hapësirë për manipulime dhe gabime.

Siç mund të shihet nga të dhënat e paraqitura në tabelën e mëposhtme, Ministria e Shëndetësisë çdo vit lidh kontrata për prokurime publike me vlerë prej 43 milionë euro vetëm me 4 persona të certifikuar. Kjo donë të thotë që secili person është përgjegjës për mesatarisht mbi 10 milionë euro vlerë të prokurimeve. Të dhënat për numrin e personave të certifikuar janë marrë nga Regjistri i Personave të certifikuar.

Klinika Universitare për Sëmundjet e Fëmijëve ka 1 person të certifikuar dhe ka lidhur kontrata me vlerë prej 16 milionë euro, që përbën rrezik të përqendrimit të pushtetit në një person. IPSH Publik "8 Shtatori" ka lidhur më tepër se 440 kontrata me vetëm 3 persona të certifikuar, që është një vëllim i madh prokurimesh me një numër të vogël të punonjësve të trajnuar.

Kjo situatë nxjerr në pah një shpërfillje të Ligjit për Prokurime Publike në ato institucione shëndetësore publike, në të cilat nuk ka asnjë person të certifikuar, megjithëse kjo është e detyrueshme, ndërsa në shumicën e institucioneve tjera sugjeron në një rrezik serioz - shumë para dhe kontrata varen nga një numër i vogël individësh (ndonjëherë vetëm një individ).

Mungesa e personave të certifikuar, të cilët i njohin mirë rregullat që kanë të bëjnë me prokurimet publike nuk është vetëm çështje teknike - kjo është një rrezik i drejtpërdrejtë për korrupsion. Pra, mungesa e ekspertizës e bënë më të lehtë korrupsionin – punonjësit nuk i njohin ose qëllimisht nuk i zbatojnë procedurat e duhura, por imponojnë afate të shkurtra, kritere diskriminuese dhe favorizojnë kompani të caktuara.

Personel i certifikuar për prokurimet publiket në ISHP-të më të mëdha

Institucioni	Numri i kontratave në vitin 2024	Numri i procedurave në vitin 2024	Vlera e prokurimeve në vitin 2024 (denarë)	Vlera e prokurimeve në vitin 2024 (në euro)	Numri i individëve të certifikuar në vitin 2024
Ministria e Shëndetësisë	75	54	2,631,162,884	42,783,136	4
Klinika Universitare për Radioterapi dhe Onkologji	102	56	1,957,958,342	31,836,721	5
Klinika Universitare për Sëmundjet e Fëmijëve	174	102	981,519,545	15,959,667	1
ISHP Spitali i Përgjithshëm i Qytetit "8 Shtatori" Shkup	442	358	814,453,631	13,243,148	3
Institucioni Publik i Fushës së shëndetësisë..	188	124	738,185,287	12,003,013	9
Klinika Universitare e Hematologjisë	70	63	677,522,113	11,016,620	3
Klinika Universitare e Kardiologjisë – Shkup	152	89	592,614,171	9,636,003	8
Klinika Universitare e Neurologjisë	46	66	440,073,387	7,155,665	1
Instituti i Mjekësisë Transfuzive i Republikës së Maqedonisë	86	122	415,170,856	6,750,746	4
Shtëpia e Shëndetit Shkup	125	111	387,658,750	6,303,394	3

3.4.2. Mekanizmat për mbikëqyrje

Pa mekanizma efektiv për mbikëqyrje dhe monitorim, ekziston rreziku që shuma të mëdha parash publike të shpenzohen pa u arritur përmirësimet përkatëse.

Analiza e korrelacionit midis numrit të rritur të vlerës së prokurimeve publike dhe numrit të zvogëluar të shërbimeve shëndetësore në Republikën e Maqedonisë së Veriut sugjeron në një disproporcion serioz midis fondeve të investuara dhe rezultateve që ato investime duhet t'i realizojnë. Pavarësisht rritjes së vazhdueshme të fondeve buxhetore të dedikuara për prokurimin e pajisjeve mjekësore, ilaçeve dhe resurseve të tjera, numri dhe disponueshmëria e shërbimeve shëndetësore janë duke u zvogëluar. Ky nuk është vetëm problem financiar, por edhe një dobësi themelore institucionale, pasi fondet e investuara nuk kontribuojnë për përmirësime të mbrojtjes shëndetësore për qytetarët.

Disa nga arsyet për këtë disproporcion, të cilat mund të përmblidhen nga raportet e ESHR-së për institucionet publike shëndetësore, ndërlidhen gjithashtu me mekanizmat pamjaftueshëm të zhvilluar të kontrollit dhe mbikëqyrjes, përkatësisht:

Kontrolli i brendshëm publik i vendosur në mënyrë të papërshtatshme – në një numër të madh të institucioneve publike shëndetësore, si dhe në Ministrinë e Shëndetësisë, sistemi i kontrollit të brendshëm publik nuk është i vendosur në mënyrë adekuate ose funksionon vetëm formalisht, pa siguruar në të vërtetë menaxhimin me rreziqet dhe parandalimin e keqpërdorimeve. Kjo rezulton në llogaridhënie të dobët dhe mungesë të mekanizmave parandalues për zbulimin me kohë të parregullsive në shpenzimin e fondeve publike.

Revizioni i brendshëm joefektiv ose inekzistent – revizioni i brendshëm, që duhet të jetë një nga veglat kryesore të mbikëqyrjes, ose nuk ekziston në një numër të madh institucionesh të mbrojtjes shëndetësore, ose nuk ka kapacitetin dhe pavarësinë për të ushtruar në mënyrë efektive rolin e vet. Mungesa e një revizioni të brendshëm aktiv dhe të pavarur krijon kushte për rrezik më të madh për korrupsion dhe transparencë të pamjaftueshme në menaxhimin me resurset publike.

Sistemi nacional i pathemeluar për punë materiale-financiare dhe kontabilitet - detyrimi ligjor për themelimin e këtij sistemin daton që nga viti 2015, por ai ende nuk është themeluar dhe për këtë arsye, shteti, nëpërmjet Ministrisë nuk e monitoron dhe nuk e kontrollon konsumin e ilaçeve, reagensëve dhe

furnizimeve të tjera mjekësore për çdo pacient në ISHP dhe si rrjedhojë ekziston një rrezik i lartë për përdorimin joadekuat dhe keqpërdorimin e tyre.

Mosveprimi sipas rekomandimeve të Entit Shtetëror të Revizionit - megjithëse Enti Shtetëror i Revizionit rregullisht ka identifikuar dobësi sistemike dhe gjetje për të cilat jep rekomandime, zbatimi i atyre rekomandimeve është në nivel shumë të ulët. Mungesa e mekanizmave për monitorimin dhe sigurimin e zbatimit të rekomandimeve dobëson efektin e raporteve të revizionit dhe mundëson përsëritjen e vazhdueshme të parregullsive dhe rreziqeve të njëjta. Mosrespektimi i rekomandimeve të ESHR-së dhe mungesa e reagimeve nga autoritetet hetimore krijon një "kulturë të mosndëshkimit". Kjo mungesë e llogaridhënies krijon përshtypjen për një tolerancë sistemike ndaj parregullsive dhe e minon besimin e publikut dhe pacientëve në kapacitetin e institucioneve për të menaxhuar me fondet publike.

Zgjatja e procedurave hetimore dhe gjyqësore – jemi dëshmitarë se në periudhën e fundit, autoritetet kompetente kanë iniciuar disa procedura hetimore ose gjyqësore për parregullsi në punën e institucioneve publike të shëndetit, të cilat janë zvarritur për një periudhë të gjatë pa pasur një përfundim final. Kjo krijon përshtypjen e sundimit joefikas të ligjit dhe në mënyrë plotësuese e dëmton besimin e publikut tek institucionet. Në të njëjtën kohë, procedurat e zvarritura japin një sinjal se llogaridhënia për keqpërdorimin e fondeve publike është në nivel të ulët ose nuk ekziston, gjë që rrit rrezikun nga korrupsioni dhe lejon përsëritje të parregullsive.